

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10 448, datë 14.7.2011, “Për Lejet e Mjedisit”, i ndryshuar”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Mjedisit
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim Acquis i BE-së
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	E zbatueshme. Direktiva 2010/75/EU për emetimet industriale (IED) të ndryshuar me IED 2.0 dhe Direktivën (EU) 2015/2193 mbi kufizimin e emetimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet e djegies me kapacitet të mesëm (MCPD)
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (NPEI) Grupi 4: Agjenda e Gjellbër dhe Ndërlidhja e Qëndrueshme Programi Kombëtar i Monitorimit Mjedisor 2026 DSIP për Direktivën e Emetimeve Industriale 2010/75/EU
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	05.06.2026-03.07.2026
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	09.07.2026
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?	Po, 29/06/2026
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2026 – MMj – Nr. 4
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT NË MINISTRI)	Olkida Naci Olkida.naci@mjedisi.gov.al

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT
Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, synon parandalimin, reduktimin dhe kontrollin e ndotjes që shkaktohet nga instalimet dhe veprimtaritë industriale. Megjithatë, përvoja e zbatimit dhe analiza e kuadrit ekzistues kanë evidentuar se sistemi aktual i lejeve të mjedisit nuk

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

është plotësisht efektiv. Lidhja ndërmjet kushteve të lejes së mjedisit dhe teknikave më të mira të disponueshme (TMD) nuk është gjithmonë e detyrueshme; procedurat për monitorim, raportim apo kontrollin e përputhshmërisë nuk janë plotësisht të standardizuara; regjimi i lejeve mbetet i fragmentuar; ndërsa aksesit i publikut në informacionin mjedisor vazhdon të jetë i kufizuar. Gjithashtu, zhvillimet e fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian, veçanërisht në kuadër të Direktivës 2010/75/BE për shkarkimet industriale (IED) dhe Direktivës (BE) 2015/2193 për kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet me djegie të mesme (MCPD), kanë nxjerrë në pah nevojën për ndërhyrje. Programi Kombëtar i Monitorimit të Mjedisit për vitin 2026, i hartuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), thekson nevojën për kontroll më të avancuar të veprimtarive me ndikim të lartë mjedisor, veçanërisht në sektorin energjetik, përfshirë nxjerrjen dhe përpunimin e naftës dhe gazit, si dhe në sektorin minerar, veçanërisht në minierat në qiell të hapur. Duke pasur parasysh këto rrethana dhe zhvillimet aktuale në kuadër të procesit të integritetit evropian, është vlerësuar e nevojshme ndërmarrja e një nisme për rishikimin dhe përmirësimin e kuadrit rregullator ekzistues për lejet e mjedisit, me qëllim garantimin e një niveli më të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe sigurimin e një mjedisi më të pastër e më të shëndetshëm për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe efektet e synuara të propozimit?

Objektivi i përgjithshëm i projektligjit është përmirësimi i cilësisë së mjedisit, përfshirë cilësinë e ajrit, dhe mbrojtjen e shëndetit publik, nëpërmjet përafrimit të mëtejshëm dhe zbatimit progresiv të kërkesave të Direktivës 2010/75/BE për shkarkimet industriale dhe Direktivës (BE) 2015/2193 për impiantet e mesme të djegies, si dhe nëpërmjet forcimit të mekanizmave të zbatimit dhe kontrollit në fushën e legjislacionit mjedisor.

Në mbështetje të këtij objektivi të përgjithshëm, projektligji synon të arrijë objektivat specifike të mëposhtme:

- Integrimi i plotë i konceptit të Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD) në procesin e dhënies dhe zbatimit të lejeve të mjedisit, duke e shndërruar TMD-në nga një referencë në një kusht detyrues të lejes së mjedisit si dhe garantimi e përditësimit periodik të lejeve të mjedisit në përputhje me zhvillimet e TMD-së.
- Sigurimi që, brenda vitit 2036, 100% e lejeve të mjedisit për instalimet e mbuluara nga Direktiva 2010/75/BE (IED) të jenë të rishikuara dhe të miratuara në përputhje me konkluzionet e zbatueshme të Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD) dhe niveleve të shkarkimeve të lidhura me to (TMD-AEL), të integruara si kushte detyruese në lejet përkatëse.
- Përcaktimin e Vlerave Kufi të Shkarkimeve (VKSH) në përputhje me nivelet e shkarkimeve të lidhura me TMD-në (TMD-AEL) dhe rishikimin e kushteve të lejes brenda katër viteve nga publikimi i vendimit për konkluzionet mbi TMD-në që lidhen me veprimtarinë kryesore të instalimi
- Forcimi i detyrimeve për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve, duke përcaktuar detyrime të qarta për operatorët për kryerjen e vetëmonitorimit të vazhdueshëm dhe përditësimin në përputhje me TMD-të e rishikuara.

- Krijimi i Sistemeve të Menaxhimit Mjedisor (SMM) të cilat sigurojnë përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore nëpërmjet planifikimit, monitorimit dhe rishikimit sistematik të proceseve dhe ndikimeve mjedisore të veprimtarisë industriale
- Sigurimi i vlerësimit dhe dokumentimit të gjendjes mjedisore para dhe pas veprimtarive me ndikim të lartë.
- Forcimi i mekanizmave për parandalimin dhe rehabilitimin e dëmeve mjedisore gjatë dhe pas aktivitetit industrial.
- Digjitalizimi i plotë i procedurave për dhënien e lejeve të mjedisit, brenda vitit 2035, duke përmirësuar efikasitetin administrativ, qasjen në të dhëna dhe mbikëqyrjen rregullatore.
- Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes publike në proceset e vendimmarrjes mjedisore në përputhje me parimet e transparencës, përgjigjeve dhe Konventës së Aarhusit.
- Sigurimi i parandalimit dhe rehabilitimit efektiv të ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore në të gjitha veprimtaritë industriale me ndikim të lartë, duke garantuar përfshirjen e raportit të gjendjes fillestare dhe detyrime për rehabilitim, si dhe rishikimin e 100% të lejeve ekzistuese brenda vitit 2030.
- Përmirësimi i cilësisë dhe disponueshmërisë së të dhënave të monitorimit të shkarkimeve nëpërmjet sistemeve të raportimit digjital;

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë alternativat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore si dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Për arritjen e objektivave, u analizuan opsionet e mëposhtme të politikave:

Opsioni 0 (Status quo), që konsiston në ruajtjen e kuadrit ligjor ekzistues pa ndërhyrje të mëtejshme, u rrëzua, pasi nuk adreson nivelet e larta të ndotjes, i lë mekanizmat e zbatimit joefektivë dhe nuk përmbush detyrimet sipas Kapitullit 27.

Opsioni 1 (Masa jorregullatore) parashikon ndërhyrje nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuere ose trajnimeve vullnetare për operatorët dhe institucionet. Ky opsion ka kosto të ulët dhe është i lehtë për t'u zbatuar, por nuk mund të garantojë detyrime ligjore për operatorët dhe sistemin e lejeve, as zbatimin e standardeve të BE-së; ky opsion konsiderohet mbështetës, por jo i mjaftueshëm.

Opsioni 2 (Ligj i ri), që konsiston në zëvendësimin e plotë të ligjit ekzistues me një ligj të ri për lejet e mjedisit, do të lejonte ristrukturimin e plotë të kuadrit ligjor, por nuk është proporcional duke pasur parasysh natyrën e ndryshimeve të kërkuara dhe mbart rrezikun e vonesave në përmbushjen e detyrimeve ndaj BE-së për shkak të proceseve të gjata të hartimit dhe miratimit.

Opsioni 3 (Ndryshimi i ligjit ekzistues) është opsioni i preferuar. Ky opsion konsiston në një ndërhyrje të synuar në ligjin nr. 10 448/2011 “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, për të përmirësuar dispozitat ekzistuese dhe për t'i përafruar ato me kërkesat e Direktivës 2010/75/BE dhe Direktivës (BE) 2015/2193. Megjithatë ai sjell kosto shtesë për monitorimin dhe zbatimin, këto justifikohen nga përfitimet.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përfshijë ndikimet me vlerë monetare të përcaktuar dhe ndikimet pa vlerë monetare të përcaktuar mbi buxhetin dhe bizneset.

Opsioni i preferuar (Opsioni 3) konsiston në ndryshimin e ligjit ekzistues nëpërmjet një ndërhyrjeje të synuar, të harmonizuar me *acquis*-në e Bashkimit Evropian.

Ndikimet në buxhetin publik. Opsioni i preferuar pritet të gjenerojë kosto shtesë për sektorin publik, të lidhura me zbatimin e kuadrit të ndryshuar të lejeve të mjedisit. Në mënyrë indikative, kostot fillestare të investimit për sektorin publik vlerësohen në rreth 7.5 milionë euro (CAPEX). Kostot vjetore operative (OPEX) vlerësohen në mënyrë indikative në rreth 2.90 milionë euro në vit. Këto vlerësime do t'i nënshtrohen analizës së mëtejshme të ndjeshmërisë, me konsolidimin e kuadrit të zbatimit të IED-së.

Kostot për sektorin privat. Sipas analizës financiare të DSIP-së, programi i investimeve për shtatë operatorët kryesorë (tetë instalime) vlerësohet në rreth 114.3 milionë euro, prej të cilave 79.3 milionë euro janë investime të detyrueshme për përputhshmërinë me BAT-in, ndërsa 35 milionë euro janë investime vullnetare të gjelbra nga një operator që tashmë është në përputhshmëri. Kostoja është e përqendruar ndjeshëm (sektori i çimentos përbën rreth 92%). Shumica e operatorëve mund të financojnë përputhshmërinë nga burimet e tyre brenda afatit standard (2030); për raste të veçanta, parashikohet një periudhë tranzitore (deri më 31.12.2036) ose financim preferencial.

Ndikimet mjedisore. Ndikimi mjedisor i opsionit të preferuar pritet të jetë i konsiderueshëm dhe i drejtpërdrejtë. Efektet kryesore përfshijnë uljen e shkarkimeve në ajër, ujë dhe tokë nëpërmjet kushteve të lejeve të bazuara në BAT dhe vlerave kufi më të rrepta.

Ndikimet sociale dhe në shëndetin publik. Ndotja e ajrit është një nga faktorët kryesorë të rrezikut mjedisor për shëndetin publik. Efektet e pritshme janë ulja e sëmundjeve të lidhura me ndotjen industriale dhe e kostove të kujdesit shëndetësor, së bashku me përmirësimin e cilësisë së jetës, veçanërisht në zonat industriale.

Ndikimet institucionale do të sjellin role më të qarta dhe kapacitete më të forta për Ministrinë e Mjedisit, AKM-në dhe strukturat inspektuese, si dhe bashkëpunim me aktorët ndërkombëtarë (Komisionin Evropian dhe agjencitë e tij, partnerët, etj.).

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare.

Opsioni 3, Ndërhyrja është e nevojshme, pasi problemet e identifikuara janë të natyrës ligjore dhe rregullatore dhe nuk mund të zgjidhen përmes masave administrative ose vullnetare. Ndryshimi i ligjit nr. 10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, konsiderohet opsioni më i përshtatshëm dhe proporcional për arritjen e objektivave të politikës. Ai parashikon një ndërhyrje të synuar dhe efikase, të harmonizuar veçanërisht me kërkesat e Direktivës 2010/75/BE për shkarkimet industriale dhe të Direktivës (BE) 2015/2193 për impiantet e mesme të djegies. Për vlerësimin e opsioneve është përdorur metoda e analizës shumëkriteriale, e bazuar në efektivitetin për arritjen e objektivave, kostot ekonomike dhe buxhetore, përafrimin me *acquis*-në, si dhe realizueshmërinë dhe afatin kohor të zbatimit. Edhe nga këndvështrimi i teknikës së hartimit legjislativ, ky është opsioni i preferuar, pasi ndryshimet nuk pritet të prekin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit. Në aspektin financiar, DSIP-ja vlerëson kostot publike në rreth 7.5 milionë euro investime (CAPEX) dhe 2.90 milionë euro në vit (OPEX), me një total të agreguar 10-vjeçar prej rreth 36.5 milionë eurosh. Përballë këtyre, përfitimet afatgjata vlerësohen të konsiderueshme, megjithëse jo të gjitha mund të monetizohen drejtpërdrejt. Ato përfshijnë uljen e kostove të kujdesit shëndetësor

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

nga reduktimi i ekspozimit ndaj ndotjes industriale, rritjen e produktivitetit ekonomik, uljen e dëmit mjedisor dhe kostove të rehabilitimit, nxitjen e investimeve në teknologji më të pastra të lidhura me BAT-in, përmirësimin e sigurisë juridike për operatorët dhe institucionet, si dhe përafrimin më të mirë me tregun e Bashkimit Evropian. Bazuar në praktikën e BE-së dhe vlerësimet e DSIP-së, përfitimet afatgjata të zbatimit efektiv pritet të tejkalojnë ndjeshëm kostot fillestare të përputhshmërisë dhe kostot institucionale.

Bazuar në strukturat institucionale ekzistuese (ministria përgjegjëse për mjedisin, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe strukturat e inspektimit mjedisor), kapacitetet aktuale të institucioneve përgjegjëse dhe vlerësimet e DSIP-së për kostot e sektorit publik, kostot buxhetore për periudhën trevjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit pritet të jenë graduale dhe të shpërndara në kohë.

Opsioni 3, që konsiston në ndryshimin e ligjit nr. 10448/2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, konsiderohet opsioni më i përshtatshëm dhe proporcional për arritjen e objektivave të politikës. Ai siguron një ndërhyrje të synuar dhe efikase, në përputhje me kërkesat e Direktivës 2010/75/BE për shkarkimet industriale, si dhe të Direktivës (BE) 2015/2193 për kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet me djegie të mesme.

Për vlerësimin e opsioneve është përdorur metoda e analizës krahasuese, bazuar në shkallën e arritjes së objektivave për arritjen e qëllimit, kostot ekonomike dhe buxhetore, nivelin e përafrimit me acquis-në e Bashkimit Evropian, si dhe realizueshmërinë dhe afatin e zbatimit. Edhe nga pikëpamja e teknikës legislative, ky opsion është i preferuar, pasi ndryshimet e propozuara nuk prekin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit në fuqi.

Në aspektin financiar, DSIP-i vlerëson kostot për sektorin publik në rreth 7,5 milionë euro për investime kapitale (CAPEX) dhe rreth 2,90 milionë euro në vit për kostot e funksionimit (OPEX), me një vlerë të përgjithshme për një periudhë 10-vjeçare prej rreth 36,5 milionë eurosh. Përballë këtyre kostove, përfitimet afatgjata vlerësohen të konsiderueshme, ndonëse jo të gjitha mund të shprehen drejtpërdrejt në terma monetarë. Këto përfitime përfshijnë uljen e kostove të kujdesit shëndetësor si rezultat i ekspozimit më të ulët ndaj ndotjes industriale, rritjen e produktivitetit ekonomik, reduktimin e dëmeve në mjedis dhe të kostove të rehabilitimit, nxitjen e investimeve në teknologji më efikase dhe miqësore me mjedisin të lidhura me TMD-të, përmirësimin e sigurisë juridike për operatorët dhe institucionet, si dhe përafrimin më të mirë me kërkesat e Bashkimit Evropian. Bazuar në praktikën e Bashkimit Evropian dhe në vlerësimet e DSIP-it, përfitimet afatgjata të zbatimit të efektshëm të projektligjit pritet të tejkalojnë ndjeshëm kostot fillestare të përputhshmërisë dhe kostot institucionale. Duke marrë parasysh strukturat institucionale ekzistuese, përfshirë Ministrinë e Mjedisit, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, strukturat përgjegjëse inspektuese në mjedis, si dhe kapacitetet aktuale të institucioneve përgjegjëse. Kostot buxhetore gjatë periudhës trevjeçare pas miratimit të ligjit pritet të jenë graduale dhe të shpërndara në kohë.

Aktivitet	Viti	Niveli i koston
Hartimi i akteve nënligjore dhe fillimi i ngritjes së sistemit.	Viti 1	I ulët (kosto administrative dhe rregullatore)

Zhvillimi i sistemit elektronik (IES), pajisjet, laboratorët	Viti 2	Mesatar
Funksionimi i konsoliduar i sistemit dhe monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit.	Viti 3	I qëndrueshëm

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar?), çfarë pikëpamjesh janë shprehur, si janë trajtuar ato, domethënë çfarë ndryshimesh janë pranuar dhe çfarë janë refuzuar dhe arsyet pse?)

Në kuadër të rishikimit të ligjit nr. 10448/2011, “Për lejet e mjedisit”, dhe hartimit të DSIP-it për zbatimin e kërkesave të Direktivës për Shkarkimet Industriale, janë organizuar disa takime konsultuese me palët e interesuara. Procesi i konsultimit ka nisur në muajin tetor 2025 dhe ka vijuar gjatë muajit nëntor 2025, duke përfshirë takime të posaçme me operatorët industrialë, të zhvilluara më 17 dhe 21 nëntor 2025. Gjatë kësaj kohe, Ministria e Mjedisit dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit kanë organizuar takime konsultuese, si në formë online, ashtu edhe me pjesëmarrje fizike. Më 9 mars 2026 u zhvillua një takim gjithëpërfshirës me operatorët që i nënshtrohen kërkesave të IED-së, për diskutimin e ndryshimeve të propozuara ligjore dhe masave për zbatimin e tyre. Gjithashtu në kuadër të konsultimit publik për projektligjin “Për lejet e mjedisit”, më datë **24.06.2026** u zhvillua një takim prezantues me pjesëmarrjen e palëve të interesuara, biznese, shoqata student, përfaqësues të institucioneve etj.. Gjatë takimit u paraqitën risitë kryesore të projektligjit, me fokus te leja e integruar e mjedisit, kushtet e lejes, zbatimi i Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD), vlerat kufi të shkarkimeve dhe mekanizmat për rishikimin e lejeve.

Gjatë diskutimit, përfaqësuesit e industrisë së çimentos, përfshirë shoqërinë “Antea Cement”, ngritën çështje lidhur me mënyrën e zbatimit të kërkesave të reja për instalimet ekzistuese të pajisura me leje mjedisi të tipit A. U theksua nevoja që kushtet e lejes dhe kërkesat teknike të marrin në konsideratë specifikat e sektorit të çimentos, teknologjitë e përdorura, si dhe dokumentet përkatëse të referencës për Teknikat më të Mira të Disponueshme. Një vëmendje e veçantë iu kushtua përcaktimit të vlerave kufitare të shkarkimeve. Pjesëmarrësit evidentuan se këto kërkesa duhet të përshtaten sipas natyrës së instalimit, procesit teknologjik dhe standardeve sektoriale të zbatueshme. Në këtë kuadër, u diskutua edhe përdorimi i lëndëve alternative, përfshirë RDF-në, në industrinë e çimentos, si dhe nevoja për përcaktimin e qartë të kërkesave dhe kufijve përkatës në aktet zbatuese. Gjithashtu, u ngrit nevoja për parashikimin e periudhave të arsyeshme tranzitore për instalimet ekzistuese, me qëllim përshtatjen graduale me kërkesat e reja të projektligjit dhe standardet e lidhura me TMD. U sqarua se projektligji përcakton kuadrin e përgjithshëm për lejet e integruara, ndërsa kërkesat teknike të detajuara dhe kushtet konkrete do të përcaktohen sipas veprimtarisë përkatëse, karakteristikave të instalimit dhe akteve nënligjore që do të miratohen në zbatim të tij. Ne vijim u sqarua se kërkesat teknike specifike për këtë sektor mbështeten në dokumentin e referencës për Teknikat më të Mira të Disponueshme (BREF) për çimenton, gëlqeren dhe oksidin e magnezit. Ky dokument përmban një kapitull të posaçëm teknik për industrinë e çimentos dhe konkluzionet përkatëse TMD, të cilat shërbejnë si bazë për përcaktimin e kushteve

të lejes dhe vlerave kufitare të shkarkimeve për instalimet e këtij sektori. U theksua se BREF-i nuk përbën një kapitull të veçantë të Direktivës për Emetimet Industriale dhe se Direktiva nuk kërkon që ligji primar të riprodhojë në mënyrë të detajuar të gjitha standardet teknike sektoriale. Projektligji përcakton kuadrin e përgjithshëm, parimet dhe detyrimin për vendosjen e kushteve të lejes në përputhje me TMD, ndërsa normat konkrete të shkarkimeve, kërkesat për monitorim dhe elementet e tjera teknike do të parashikohen në ndryshimet e akteve nënligjore përkatëse, përfshirë ndryshimet në VKM-në që rregullon kushtet dhe procedurat për lejet e mjedisit. Në përfundim, palët e interesuara u informuan se komentet dhe propozimet e detajuara mund të përcillen me shkrim përmes adresës elektronike zyrtare ose faqes së konsultimit publik, brenda afatit të përcaktuar për konsultimin. Gjithashtu në takim morën pjesë edhe përfaqësues të Bashkisë Tiranë, të cilët informuan se Bashkia ka miratuar së fundmi Planin e Veprimit për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit. Në këtë kuadër, u theksua interesi për përcaktimin e masave konkrete që lidhen me respektimin e normave të shkarkimeve dhe forcimin e monitorimit të bizneseve që ushtrojnë veprimtari me ndikim në cilësinë e ajrit. Përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë diskutuan rëndësinë e koordinimit ndër-institucional për identifikimin e burimeve kryesore të ndotjes, ndjekjen e zbatimit të masave të parashikuara në Planin e Veprimit dhe forcimin e kontrollit mbi veprimtaritë që ndikojnë në cilësinë e ajrit. Nga shoqata EDEN u vu theksi te garantimi i së drejtës së publikut për t'u informuar dhe për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse që lidhen me lejet e mjedisit. U kërkuar sqarim mbi mënyrën se si do të zhvillohet procedura e konsultimit, si do të publikohet informacioni për aplikimet, projektvendimet dhe kushtet e lejeve, si dhe si do të sigurohet që komentet e publikut të merren në konsideratë në procesin e vendimmarrjes. Në përgjigje, u sqarua se projektligji vendos parimet dhe detyrimet bazë për garantimin e informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në procedurat për lejet e mjedisit, ndërsa rregullat e detajuara për mënyrën e zhvillimit të konsultimit, publikimin e dokumentacionit, afatet, format e njoftimit dhe trajtimin e komenteve do të përcaktohen në aktet nënligjore zbatuese. Këto akte do të përcaktojnë procedura të qarta për aksesin e publikut në informacion, paraqitjen e komenteve dhe pasqyrimin e tyre në vendimmarrjen përfundimtare. Në përfundim të takimit ju kërkuar pjesëmarrësve që komentet të paraqiten në mënyrë të strukturuar dhe të dërgohen me email, për të cilat ende nuk është paraqitur ndonjë sugjerim apo kërkesë. Çështjet e ngritura nga përfaqësuesit e industrisë, përfshirë referimin te dokumenti BREF për çimenton, gëlqeren dhe oksidin e magnezit, si dhe përcaktimin e normave të shkarkimeve dhe kërkesave për monitorim në aktet nënligjore, do të rishikohen më tej nga grupi i cili po punon me draft ligjin në mbështetje me ekspertët Teknik që kanë mbështetur hartimin e projektligjit. Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik dhe shqyrtimit të komenteve të paraqitura, projektligji pritet t'i përcillet Komisionit Evropian për vlerësim paraprak, në kuadër të procesit të përafrimit me Direktivën 2010/75/BE për shkarkimet industriale (IED) dhe Direktivën (BE) 2015/2193 për kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet me djegie të mesme (MCPD).

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi? (jo më shumë se 5 rreshta)

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Zbatimi i projektligjit për lejet e mjedisit kërkon një sistem të strukturuar dhe të koordinuar për administrimin, monitorimin dhe zbatimin e kërkesave të tij, me qëllim sigurimin e një ndikimi real dhe të matshëm në përmirësimin e cilësisë së mjedisit, mbrojtjen e shëndetit publik dhe përafrimin me kërkesat e Bashkimit Evropian. Procesi udhëhiqet nga Ministria e Mjedisit, me mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, strukturave përgjegjëse për inspektimin, Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe njësive të vetëqeverisjes vendore. Agjencia Kombëtare e Mjedisit përgatit lejet e mjedisit, përcakton kushtet teknike dhe nivelet e shkarkimeve të lidhura me Teknikat më të Mira të Disponueshme, administron bazën përkatëse të të dhënave dhe ndjek planet e transformimit të instalimeve. Ministri nënshkruan lejet e mjedisit të tipit A dhe B, ndërsa Qendra Kombëtare e Biznesit i lëshon ato në formë elektronike. Strukturat inspektuese verifikojnë përputhshmërinë e operatorëve me kushtet e lejes dhe kërkesat e legjislacionit në fuqi. Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përmbushjen e kushteve të lejes së mjedisit, zbatimin e kërkesave të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor, kryerjen e vetëmonitorimit të shkarkimeve dhe të mjedisit pritës, si dhe raportimin e të dhënave përkatëse.

Projektligji parashikon zbatimin e standardeve teknike të bazuara në Teknikat më të Mira të Disponueshme, forcimin e mekanizmave të kontrollit, monitorimit dhe verifikimit, si dhe rritjen e kapaciteteve institucionale për rishikimin e lejeve të mjedisit në përputhje me konkluzionet për TMD-në. Zbatimi i tij mbështetet kryesisht në kuadrin institucional ekzistues dhe në Sistemin Informativ Mjedisor, ndaj nuk pritet të sjellë rritje të ndjeshme të barrës administrative. Synohet përmirësimi i efikasitetit, transparencës dhe cilësisë teknike të procedurave të lejimit dhe të mbikëqyrjes së përputhshmërisë mjedisore. Progresi do të matet nëpërmjet përqindjes së përputhshmërisë së operatorëve, numrit të tejkalimeve të Vlerave Kufitare të Shkarkimeve, numrit të lejeve të rishikuara në përputhje me konkluzionet për TMD-në, si dhe nivelit të publikimit online të informacionit në bazën e të dhënave të lejeve të mjedisit dhe në Regjistrin PRTR. Zbatimi do të shoqërohet me vlerësim periodik dhe rishikim të kushteve të lejes së mjedisit në përputhje me zhvillimet teknologjike.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE PROVAVE

HISTORIK

Jepni kontekstin e politikës.

Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, është akti kryesor ligjor që rregullon sistemin e lejeve të mjedisit në Republikën e Shqipërisë. Ligji përcakton regjimin e lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, si dhe rolet dhe përgjegjësitë kryesore të institucioneve kompetente për shqyrtimin, miratimin, lëshimin, monitorimin dhe kontrollin e tyre. Në vitin 2021, pas përfundimit të procesit të Këshillimit Kombëtar, ministria përgjegjëse për mjedisin ndërmori hapa për zbatimin e nismave të identifikuara si prioritare. Në këtë kuadër, u vlerësua e nevojshme forcimi i regjimit të kundërvajtjeve administrative, duke parashikuar rritjen me rreth 30% të sanksioneve të zbatueshme krahasuar me nivelet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për lejet e mjedisit. Në vitin 2024, në kuadër të përmirësimit të kuadrit ligjor në fushën e mjedisit, u miratua ligji nr. 108/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, ‘Për lejet e mjedisit’, të ndryshuar”. Këto ndërhyrje synuan sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe reduktimin e rreziqeve për jetën dhe shëndetin e njeriut, si dhe krijimin e

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Këto objektiva synohen të arrihen nëpërmjet parandalimit, kontrollit dhe mbrojtjes së mjedisit, duke kontribuar në përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore, cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut.

Kuadri ekzistues strategjik dhe ligjor

Kuadri rregullator në fushën e lejeve të mjedisit përbëhet nga një tërësi aktesh ligjore dhe nënligjore, të cilat ndërveprojnë dhe plotësojnë njëra-tjetrën. Harmonizimi dhe zbatimi i koordinuar i këtyre akteve është i nevojshëm për të garantuar një proces të unifikuar dhe efektiv për dhënien, monitorimin, rishikimin dhe kontrollin e lejeve, si dhe për përmbushjen e kërkesave të acquis-së së Bashkimit Evropian.

- Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 119/2014, datë 18.9.2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2014, datë 4.12.2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 419, datë 25.6.2014, “Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga Qendra Kombëtare e Biznesit”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 372, datë 18.5.2016, “Për miratimin e rregullave të komunikimit, konsultimit dypalësh dhe vendimmarrjes për lejen e mjedisit të tipit A, për funksionimin e instalimit të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që ka mundësi reale të krijojë efekte negative të konsiderueshme në mjedisin e një shteti tjetër, ose menjëherë pasi i kërkohet nga ky shtet”, i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 178, datë 6.3.2012, “Për incinerimin e mbetjeve”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 908, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e masave për kufizimin e shkarkimit të përbërësve organikë të avullueshëm nga përdorimi i tretësve organikë në disa veprimtari dhe instalime”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 12.11.2025, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të Sistemit të Integruar Mjedisor (SIM)”.

PROBLEMI NË SHQYRTIM

Përshkruani natyrën e problemit. Identifikoni shkaqet e problemit. Përshkruani shtrirjen e problemit. Identifikoni grupet e prekura nga ky problem – qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët. Vlerësoni nëse problemi mund ose jo të trajtohet përmes një ndryshimi të politikës.

1. Natyra e problemit

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Veprimtaritë industriale dhe agro-industriale, përfshirë industrinë e naftës, metalurgjinë, prodhimin e çimentos, industrinë kimike, trajtimin e mbetjeve dhe mbarështimin intensiv të kafshëve, mund të shkaktojnë shkarkime të ndotësve në ajër, ujë dhe tokë, si dhe të ndikojnë në shëndetin e njeriut. Për këtë arsye, Direktiva 2010/75/BE për shkarkimet industriale parashikon një sistem të integruar për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes, sipas të cilit kushtet e lejes për instalimet duhet të përcaktohen duke u bazuar në Teknikat më të Mira të Disponueshme (TMD), përfundimet përkatëse për TMD-në dhe nivelet e shkarkimeve të lidhura me TMD-në (TMD-AEL).

Referuar ligjit ekzistues të lejeve të mjedisit konstatohen problematikat e mëposhtme:

Mungesa e një kuadri rregullator të harmonizuar dhe të integruar për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes industrial. Ligji nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, së bashku me aktet nënligjore, përbën bazën e sistemit kombëtar të lejeve. Megjithatë, sipas analizës së kryer, Kuadri ligjor ekzistues për lejet e mjedisit nuk pasqyron plotësisht kërkesat dhe instrumentet e parashikuara nga Direktiva 2010/75/BE, duke kufizuar zbatimin e një qasjeje të integruar për parandalimin dhe kontrollin e ndotjes. Evidentohet se mungojnë lejet e integruara të bazuara në TMD, vlerat kufi të shkarkimeve nuk janë plotësisht të harmonizuara me TMD-AEL, monitorimi nuk është sistematik sipas standardeve të Bashkimit Evropian dhe të dhënat për lejet, inspektimet dhe raportimin publik mbeten të fragmentuara. Mungesa e dispozitave të detajuara ka sjellë vështirësi në sigurimin e një niveli të lartë dhe të njëtrajtshëm të mbrojtjes së mjedisit

Mungesa kryesore e harmonizimit lidhet me mënyrën se si TMD-ja dhe TMD-AEL-të lidhen me kushtet e lejes. Direktiva kërkon që institucionet përgjegjëse të përcaktojnë vlerat kufi të shkarkimeve në kushtet e lejes duke marrë si bazë nivelet e shkarkimeve të lidhura me TMD-në. Kjo do të thotë se përfundimet për TMD-në nuk shërbejnë vetëm si udhëzim teknik, por duhet të përkthehen në kërkesa konkrete, të matshme dhe të zbatueshme për operatorin, përfshirë vlerat kufi të shkarkimeve, kërkesat për monitorim, kushtet e funksionimit dhe masat e kontrollit të ndotjes.

Në legjislacionin shqiptar TMD-ja përmendet si element vlerësimi, por kuadri ligjor nuk përcakton shprehimisht dhe në mënyrë detyruese që vlerat kufi të shkarkimeve në kushtet e lejes duhet të bazohen në TMD-AEL-të e zbatueshme. Vlerat kufi kombëtare përcaktohen kryesisht në ligjin nr. 10448/2011, VKM-në nr. 419/2014 dhe akte të tjera sektoriale, por nuk ekziston një kërkesë e qartë që ato të lidhen me TMD-AEL-të, Direktivës. Për disa sektorë, vlerat kombëtare janë më pak të rrepta se nivelet e lidhura me TMD-në ose mungojnë plotësisht.

Në këtë kuptim, lidhja me TMD-në nuk është plotësisht detyruese sepse autoriteti kompetent nuk ka një detyrim të shprehur ligjor që, për çdo instalim të përfshirë në fushën e IED-së, të marrë për bazë përfundimin përkatës për TMD-në dhe të vendosë në kushtet e lejes vlera kufi të shkarkimeve në përputhje me TMD-AEL-të. Në mungesë të këtij detyrimi, operatori detyrohet të respektojë vetëm vlerat kufi të parashikuara në lejen e tij edhe kur këto vlera nuk janë përditësuar ose nuk korrespondojnë me standardet teknike më të avancuara të zbatueshme në nivel të Bashkimit Evropian. Për rrjedhojë, TMD-ja mbetet kryesisht një referencë teknike dhe jo domosdoshmërisht bazë e detyrueshme për përmbajtjen e çdo leje.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Kjo problematikë lidhet edhe me mungesën e një mekanizmi të qartë për rishikimin e kushteve të lejes pas publikimit të përfundimeve të reja për TMD-në. Direktiva kërkon që kushtet e lejes të rishqyrtohen dhe të përshtaten me zhvillimet teknike dhe përfundimet e reja për TMD-në. Kuadri aktual nuk përmban një mekanizëm të rregullt për rishikimin ose përditësimin e lejeve pas publikimit të përfundimeve të reja për TMD-në dhe rekomandon vendosjen e detyrimit për rishqyrtimin e tyre brenda katër viteve ose pas publikimit të përfundimeve të reja për TMD-në.

Si pasojë, kushtet e lejes mund të vazhdojnë të zbatohen për periudha të gjata pa reflektuar zhvillimet teknologjike, reduktimet e reja të arritshme të shkarkimeve ose kërkesat e përditësuara për monitorim. Kjo krijon rrezik për trajtim jo të njëtrajtshëm të operatorëve, për ruajtjen e standardeve më të ulëta të kontrollit të ndotjes dhe për mosgarantinë e një niveli të njëjtë mbrojtjeje për ajrin, ujin, tokën dhe shëndetin e njeriut.

2. Mungesa e instrumenteve moderne për monitorimin, raportimin dhe transparencën mjedisore

Legjislacioni aktual nuk parashikon instrumente të plota dhe të integruara për administrimin, monitorimin dhe publikimin e informacionit mjedisor. Mungesa e bazave publike të të dhënave, e sistemeve të integruara të raportimit elektronik, e mekanizmave të monitorimit të mjedisit pritës dhe e portalit të shkarkimeve industriale kufizon transparencën, monitorimin efektiv të performancës mjedisore dhe aksesin e publikut në informacion.

Të dhënat e monitorimit paraqiten në formate jo të njëtrajtshme, mungojnë procedurat e standardizuara për sigurimin e cilësisë, ndërsa sistemet e monitorimit të vazhdueshëm të shkarkimeve përdoren rrallë. Po ashtu, mungon një sistem elektronik i integruar që të lidhë kushtet e lejes, rezultatet e monitorimit, gjetjet e inspektimeve dhe historikun e përputhshmërisë së operatorit.

Këto boshllëqe e bëjnë të vështirë verifikimin nëse operatori respekton kushtet e lejes dhe nëse shkarkimet e tij janë në përputhje me standardet e zbatueshme. Në praktikë, institucionet kompetente mund të mos kenë informacion të plotë, të krahasueshëm dhe të përditësuar për të identifikuar tejkalimet, për të kërkuar masa korrigjuese ose për të rishikuar në kohë kushtet e lejes.

Kuadri aktual nuk pasqyron plotësisht as kërkesat e reja të Direktivës së ndryshuar 2010/75/BE. Këto përfshijnë vendosjen e sistemeve të menaxhimit mjedisor, procedurat e digjitalizuara, planet e transformimit industrial, forcimin e zbatimit dhe transparencën e zgjeruar. Legjislacioni shqiptar nuk kërkon ende zbatimin e sistemeve formale të menaxhimit mjedisor për instalimet IED dhe nuk parashikon integrimin e verifikimit të tyre në procedurat e rishikimit të lejes ose të inspektimit.

3. Mungesa e mekanizmave të avancuar për menaxhimin e rrezikut mjedisor dhe të substancave të rrezikshme

Kuadri aktual nuk përmban instrumente të mjaftueshme për identifikimin, monitorimin dhe menaxhimin e substancave të rrezikshme dhe substancave me rrezikshmëri shumë të lartë. Mungesa e inventarëve të kimikateve, e raporteve bazë për gjendjen e mjedisit dhe e mekanizmave për rehabilitimin e zonave të ndotura kufizon aftësinë për të parandaluar dhe menaxhuar ndikimet afatgjata në mjedis dhe shëndetin e njeriut.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

4. Promovim i pamjaftueshëm i inovacionit, transformimit industrial dhe dekarbonizimit

Legjislacioni ekzistues nuk përmban instrumente specifike për të nxitur përdorimin e teknikave në zhvillim, transformimin industrial dhe tranzicionin drejt proceseve industriale më të pastra dhe me emetime më të ulëta. Mungesa e planeve të transformimit, e mekanizmave për promovimin e inovacionit dhe e integritetit të objektivave të dekarbonizimit kufizon aftësinë e sektorit industrial për t'iu përshtatur kërkesave të reja mjedisore dhe klimatike.

5. Mungesa e instrumenteve të detyrueshme për menaxhimin mjedisor dhe sigurimin e përputhshmërisë

Kuadri aktual nuk parashikon detyrime të plota për krijimin, auditimin dhe monitorimin e sistemeve të menaxhimit mjedisor në instalimet industriale. Po ashtu, mungojnë mekanizma të konsoliduar për sigurimin e përputhshmërisë, monitorimin e performancës mjedisore dhe kontrollin e vazhdueshëm të zbatimit të kushteve të lejeve.

6. Fushë e kufizuar e zbatimit dhe mbulim i pamjaftueshëm i aktiviteteve industriale me ndikim të lartë mjedisor

Fusha aktuale e zbatimit të ligjit nuk mbulon plotësisht disa kategori aktiviteteve industriale dhe agro-industriale me potencial të konsiderueshëm ndotës ose me rëndësi strategjike për tranzicionin industrial dhe energjetik. Mungesa e përfshirjes së aktiviteteve të reja, si prodhimi i baterive, prodhimi i hidrogjenit, nxjerrja dhe përpunimi i mineraleve kritike, si dhe disa procese të përpunimit industrial dhe trajtimit të mbetjeve, krijon boshllëqe rregullatore dhe kufizon efektivitetin e sistemit të lejeve mjedisore.

7. Fragmentimi i kuadrit normativ dhe kompleksiteti i strukturës ekzistuese të ligjit

Struktura aktuale e ligjit dhe e shtojcave përkatëse paraqet vështirësi në interpretim dhe zbatim, për shkak të fragmentimit të dispozitave, mbivendosjeve dhe mungesës së sistematizimit të plotë. Kjo situatë krijon paqartësi për autoritetet përgjegjëse dhe operatorët ekonomikë, duke ndikuar në efikasitetin e administrimit dhe zbatimit të kuadrit ligjor për lejet e mjedisit

Tabelë 1: Përmbledhje e operatorëve industrialë potencialisht subjekt i IED në Shqipëri

Sektori dhe kodi IED	Numri i instalimeve	Shkarkimet kryesore / ndikimet në mjedis	Nevojat kryesore për përputhshmëri me IED 2.0	Lloji i lejes së mjedisit
Industria e naftës Kodi 1.2	6	Ndotës në ajër (SO ₂ , NO _x , VOC), ujëra të ndotura me përmbajtje vajore dhe ndotje e tokës.	Zbatimi i TMD-ve për rafinimin dhe magazinimin; kontrolli dhe monitorimi i vazhdueshëm i shkarkimeve; përmirësimi i menaxhimit të ujërave të ndotura; hartimi i planeve për rehabilitimin e vendndodhjes.	A; B

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Industria metalurgjike Kodi 2	9	Pluhur, metale të rënda, gazra acidë dhe shkarkime ujore të ndotura.	Zbatimi i TMD-ve për reduktimin e shkarkimeve, përfshirë filtrat dhe pastruesi e gazrave (skruberi); modernizimi i furrave; rritja e eficiencës energjetike; menaxhimi i sigurt i mbetjeve dhe skorieve.	A
Industria e çimentos Kodi 3.1/b	3	CO ₂ , NO _x , SO ₂ dhe lëndë grimcore.	Rritja e eficiencës energjetike; zëvendësimi i klinkerit; kontrolli i rreptë i shkarkimeve nëpërmjet sistemeve të avancuara të trajtimit të gazrave; bashkëpërpunimi i mbetjeve si lëndë djegëse alternative, në përputhje me TMD-të.	A
Industria e qeramikës Kodi 3.5	5	Pluhur, shkarkime të fluorit dhe gazra të djegies.	Zbatimi i TMD-ve për eficiencën e furrave dhe kontrollin e shkarkimeve; rikuperimi i energjisë; monitorimi i shkarkimeve të procesit.	A
Industria kimike Kodet 4.1 dhe 4.2	9	VOC, gazra toksikë, ujëra të ndotura kimike dhe mbetje të rrezikshme.	Zbatimi i TMD-ve për kontrollin e shkarkimeve; magazinimi dhe trajtimi i sigurt i kimikateve; monitorimi i proceseve; përmirësimi i trajtimit të ujërave të ndotura dhe mbetjeve.	A
Industria e eksplozivëve Kodet 4.6 dhe 5.2/b	1	NO _x , lëndë grimcore dhe rrezik i shkarkimeve aksidentale.	Forcimi i sistemeve të menaxhimit të rrezikut dhe kontrollit; zbatimi i TMD-ve për shkarkimet dhe menaxhimin e mbetjeve; garantimi i gatishmërisë për emergjenca, në përputhje me kërkesat e Seveso III.	A
Menaxhimi i mbetjeve Kodi 5	14	Shkarkime në ajër, përfshirë NO _x , CO dhe pluhur; ujëra të ndotura; mbetje.	Zbatimi i TMD-ve për djegien dhe rikuperimin e energjisë; përmirësimi i monitorimit të shkarkimeve; menaxhimi i hirit dhe mbetjeve; koordinimi me autoritetet vendore.	A
Rritja intensive e shpendëve ose derrave Kodi 6.6	10	Amoniak, erëra, ujëra të ndotura organike dhe ngarkesa me lëndë ushqyese.	Magazinimi dhe menaxhimi i plehut organik në përputhje me TMD-të; trajtimi i ujërave të ndotura; kontrolli dhe monitorimi i erërave dhe shkarkimeve në ajër; menaxhimi i lëndëve ushqyese.	A
Regjia e lëkurëve dhe e gëzofëve Kodi 6.3	1	Ujëra të ndotura me ngarkesë të lartë organike, sulfide, krom, klorure dhe lëndë të ngurta pezull.	Reduktimi i konsumit të ujit dhe kimikateve; zëvendësimi ose kontrolli i substancave të rrezikshme; optimizimi i proceseve të lagës, gëlqerëzimit, heqjes së gëlqerës, regjjes, ngjyrosjes dhe përfundimit; ndarja dhe trajtimi i rrjedhave të ujërave të ndotura.	B
Veprimtari të tjera Kodi 6	1	Ujëra të ndotura me ngarkesë të lartë organike dhe erëra.	Përmirësimi i impianteve të trajtimit; menaxhimi i llumrave; koordinimi i procedurave të lejeve të mjedisit ndërmjet AKM-së, Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.	A; B

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Gjithsej	59			
----------	----	--	--	--

2. Shkaqet e problemit

Problemi buron nga disa shkaqe rrënjësore, të ndërlidhura në planin ligjor, teknik, institucional dhe procedural.

1. Baza ligjore aktuale nuk e bën detyruese lidhjen ndërmjet kushteve të lejes dhe Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD). Legjislacioni në fuqi përmban referenca ndaj TMD-së dhe parashikon vlera kufi për disa ndotës e sektorë, por nuk përcakton shprehimisht që autoriteti kompetent duhet të bazojë kushtet e lejes, përfshirë vlerat kufitare të shkarkimeve, në nivelet e shkarkimeve të lidhura me TMD-në (TMD-AEL). Kjo nënkupton se TMD-ja mund të përdoret si referencë teknike, por nuk shndërrohet domosdoshmërisht në kërkesë konkrete dhe të detyrueshme për operatorin nëpërmjet lejes. Si pasojë, operatori mund të respektojë kushtet e lejes në fuqi edhe kur këto kushte nuk pasqyrojnë plotësisht standardet teknike më të përditësuara të BE-së. Në disa sektorë, vlerat kombëtare janë më pak të rrepta se TMD-AEL-të ose mungojnë.

2. Mungon një mekanizëm i plotë dhe i detyrueshëm për rishikimin e kushteve të lejes. Kuadri aktual nuk garanton që, pas publikimit të përfundimeve të reja për TMD-në ose zhvillimeve të rëndësishme teknologjike, kushtet e lejes të rishqyrtohen dhe, sipas rastit, të përditësohen brenda një afati të përcaktuar. Për pasojë, lejet mund të mbeten në fuqi për periudha të gjata pa reflektuar standarde të reja për reduktimin e shkarkimeve, monitorimin ose përdorimin e teknikave më efikase. Është identifikuar mungesa e një mekanizmi të rregullt për rishikimin e lejeve pas përfundimeve të reja për TMD-në.

3. Monitorimi, raportimi dhe verifikimi i përputhshmërisë janë të fragmentuara. Formatet aktuale të lejeve nuk përfshijnë në mënyrë të plotë TMD-AEL-të, kërkesat për vetëmonitorim dhe afatet për rishikimin e tyre. Të dhënat e monitorimit paraqiten në formate jo të njëtrajtshme, jo gjithmonë shoqërohen me procedura të standardizuara të sigurimit të cilësisë dhe nuk lidhen në mënyrë të integruar me rezultatet e inspektimeve. Kjo e vështirëson identifikimin e tejkallimeve, ndjekjen e masave korrigjuese dhe vlerësimin e historikut të përputhshmërisë së secilit operator.

4. Kuadri nuk pasqyron plotësisht instrumentet e reja të Direktivës së ndryshuar 2010/75/BE. Në veçanti, kërkesat për sistemet e menaxhimit mjedisor, digjitalizimin e procedurave, planet e transformimit industrial, forcimin e transparencës dhe mekanizmat e zgjeruar të zbatimit nuk janë ende të integruara plotësisht në kuadrin ekzistues. Nuk ekziston detyrim i qartë për operatorët e instalimeve IED që të zbatojnë sisteme formale të menaxhimit mjedisor dhe që verifikimi i tyre të lidhet me rishikimin e lejes ose kontrollin e përputhshmërisë.

5. Rregullimi sektorial dhe fusha e zbatimit nuk janë mjaftueshëm të qarta për të gjitha instalimet me ndikim të konsiderueshëm. Në veçanti, kuadri aktual nuk trajton në mënyrë të plotë kërkesat për impiantet e djegies me kapacitet të mesëm, përfshirë procedurat e lejimit ose regjistrimit, monitorimin, raportimin dhe verifikimin e përputhshmërisë. Mungesa e kërkesave të posaçme mund të sjellë zbatim jo të njëtrajtshëm dhe trajtim të ndryshëm për operatorë që zhvillojnë veprimtari të krahueshme. Projektligji parashikon rregulla të posaçme për këto impiante, përfshirë kërkesat për monitorim, raportim dhe kontroll të përputhshmërisë.

6. Transparenca, pjesëmarrja e publikut dhe kapacitetet institucionale mbeten të kufizuara. Aktualisht nuk ekziston një regjistër elektronik i plotë dhe i kërkuarshëm që të lidhë informacionin për lejet, kushtet e tyre, rezultatet e monitorimit, inspektimet dhe statusin e përputhshmërisë. Pjesëmarrja e publikut lidhet kryesisht me procedurat e VNM-së dhe nuk zbatohet në mënyrë sistematike për

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

dhënien, ndryshimin thelbësor ose rishikimin e lejeve të integruara. Evidentohet mungesë kapacitetesh teknike dhe ekspertize të specializuara për TMD-në, lejimin e integruar, monitorimin dhe inspektimin e instalimeve IED.

Projektligji synon t'i adresojë këto shkaqe duke e lidhur përcaktimin e kushteve të lejes me TMD-në dhe TMD-AEL-të, duke vendosur rishikimin e lejeve brenda katër viteve nga publikimi i përfundimeve përkatëse për TMD-në, si dhe duke forcuar monitorimin, transparencën, pjesëmarrjen e publikut dhe digjitalizimin e informacionit për lejet.

3. Fusha e problemit

Problemi ka shtrirje kombëtare dhe prek të gjithë territorin, me intensitet më të lartë në zonat ku ushtrohen veprimtari me ndikim të lartë në mjedis, veçanërisht industria energjetike (nxjerrja dhe përpunimi i naftës dhe gazit) dhe industria minerare (minierat me shfrytëzim në sipërfaqe të hapur), të cilat përbëjnë burime të konsiderueshme presioni. Fusha e rregullimit shtrihet gjithashtu në veprimtari të reja që rrjedhin nga IED 2.0, si prodhimi i baterive, nxjerrja e mineraleve kritike, prodhimi i hidrogjenit dhe trajtimi i mbetjeve. Pa ndërhyrje, ndikimi në mjedis dhe shëndet pritet të vijojë dhe të përkeqësohet me zgjerimin e veprimtarisë industriale.

4. Grupet e prekura

-
- **Qytetarët dhe komuniteti vendas**, veçanërisht ata që banojnë pranë zonave industriale, minerare, energjetike ose pranë instalimeve për trajtimin e mbetjeve, preken nga rreziku i ekspozimit ndaj shkarkimeve në ajër, ujë dhe tokë. Mungesa e një lidhjeje të detyrueshme të kushteve të lejes me TMD-AEL-të, monitorimi jo gjithmonë i standardizuar dhe rishikimi jo sistematik i lejeve mund të ndikojnë në efektivitetin e kontrollit të ndotjes dhe, për rrjedhojë, në cilësinë e mjedisit dhe shëndetin e popullsisë.
- **Operatorët ekonomikë që zhvillojnë veprimtari industriale** preken nga mungesa e kërkesave të unifikuara dhe të përditësuara për kushtet e lejes, vlerat kufitare të shkarkimeve, monitorimin dhe rishikimin e tyre. Kjo krijon pasiguri për standardet që duhet të zbatohen, trajtim jo të njëtrajtshëm ndërmjet operatorëve me veprimtari të ngjashme dhe vështirësi në planifikimin e investimeve për përmirësimin teknologjik dhe përputhshmërinë mjedisore.
- **Institucionet publike kompetente**, përfshirë institucionet përgjegjëse për hartimin e politikave, lëshimin e lejeve, monitorimin dhe inspektimin, preken nga mungesa e procedurave të plota për përcaktimin e kushteve të lejes mbi bazën e TMD-së, nga të dhënat e fragmentuara dhe nga mungesa e ndërlidhjes së informacionit për lejet, monitorimin dhe inspektimet. Kjo vështirëson verifikimin e përputhshmërisë, identifikimin e tejkallimeve dhe ndërmarrjen në kohë të masave korrigjuese.
- **Sistemi i shëndetit publik** preket në mënyrë të tërthortë nga pasojat e mundshme të ndotjes industriale, përfshirë rritjen e nevojës për trajtim të problematikave shëndetësore të lidhura me ekspozimin ndaj ndotësve. Kontrolli jo mjaftueshëm efektiv i shkarkimeve mund të sjellë gjithashtu kosto shtesë sociale dhe ekonomike për komunitetet dhe institucionet publike.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

- **Publiku i interesuar dhe organizatat e shoqërisë civile** preken nga qasja e kufizuar në informacion të plotë, të përditësuar dhe të kërkueshëm për instalimet, kushtet e lejeve, rezultatet e monitorimit, inspektimet dhe statusin e përputhshmërisë. Pjesëmarrja e tyre në procedurat e lejeve të integruara nuk zbatohet ende në mënyrë sistematike, pasi në praktikë lidhet kryesisht me procedurat e VNM-së.

5. A mund të zgjidhet problemi përmes ndryshimit të politikës?

Po, sepse baza ligjore e paplotë, mungesa e një lidhje detyruese me TMD-në, fragmentimi i regjimit të lejeve të mjedisit dhe dobësia e monitorimit janë të natyrës ligjore dhe rregullatore.

ARSYEJA PËR NDËRHYRJEN

Shpjegoni pse qeveria planifikon të ndërhyjë dhe pse është e nevojshme. Shpjegoni çfarë shpreson të adresojë qeveria përmes kësaj ndërhyrjeje. Përcaktoni shkallën e ndërhyrjes së qeverisë që nevojitet për të adresuar problemin. Shpjegoni se si kjo ndërhyrje mbështet objektivat e nivelit të lartë të qeverisë. Renditni punën ekzistuese të kryer tashmë.

1. Pse ndërhyjnë qeveria dhe pse është e nevojshme

Aktualisht, në kuadër të procesit të integritetit evropian, është vlerësuar përsëri e nevojshme ndërmarrja e një nisme për rishikimin dhe përafrimin e mëtejshëm të kuadrit rregullator për lejet e mjedisit me Direktivën 2010/75/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 24 nëntor 2010, për shkarkimet industriale, të ndryshuar, si dhe me Direktivën (BE) 2015/2193 për kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga impiantet me djegie të mesme. Kjo nismë synon garantimin e një niveli më të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe sigurimin e një mjedisi më të pastër e më të shëndetshëm për qytetarët e Republikës së Shqipërisë.

Nga vlerësimi i kuadrit ligjor ekzistues nuk parashikohen instrumente të detyrueshme për sistemet e menaxhimit mjedisor, raportet bazë, monitorimin e mjedisit pritës, planet e transformimit industrial, menaxhimin e substancave të rrezikshme dhe publikimin e informacionit mjedisor në format elektronik. Mungesa e këtyre instrumenteve kufizon aftësinë e autoriteteve për të monitoruar, kontrolluar dhe parandaluar në mënyrë efektive ndikimet mjedisore të veprimtarive industriale.

Sistemi aktual i lejeve të mjedisit nuk siguron një lidhje detyruese ndërmjet kushteve të lejes dhe niveleve të shkarkimeve të lidhura me Teknikat më të Mira të Disponueshme (TMD-AEL), nuk përmban instrumentet kryesore të Direktivës së ndryshuar 2010/75/BE (IED 2.0) dhe rregullon vetëm pjesërisht impiantet e mesme të djegies.

Po ashtu, fusha aktuale e zbatimit të ligjit nuk mbulon plotësisht disa aktivitete industriale dhe agro-industriale me potencial të konsiderueshëm ndotës, përfshirë aktivitete të reja strategjike si prodhimi i baterive, prodhimi i hidrogjenit, nxjerrja dhe përpunimi i mineraleve kritike, si dhe disa procese të trajtimit të mbetjeve dhe përpunimit industrial. Në të njëjtën kohë, impiantet me djegie me kapacitet të mesëm rregullohen vetëm pjesërisht.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Për më tepër, legjislacioni aktual nuk siguron mekanizma të mjaftueshëm për promovimin e inovacionit, dekarbonizimit, efikasitetit të burimeve dhe ekonomisë qarkulluese, në përputhje me zhvillimet e fundit të acquis të Bashkimit Evropian. Pa ndërhyrje ligjore, këto mangësi do të vazhdojnë të ndikojnë në efektivitetin e sistemit të lejeve të mjedisit, do të kufizojnë mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut dhe do të pengojnë përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit në kuadër të Kapitullit 27 "Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike".

..

2. Çfarë synon të adresojë qeveria

Qeveria synon të adresojë mangësitë e kuadrit aktual të lejeve të mjedisit, duke kaluar nga një qasje tradicionale, e fokusuar kryesisht në kontrollin e shkarkimeve, drejt një sistemi modern, të integruar dhe parandalues të menaxhimit të ndikimeve mjedisore të veprimtarive industriale. Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje synohet të sigurohet lidhja e detyrueshme ndërmjet kushteve të lejes dhe niveleve të shkarkimeve të lidhura me Teknikat më të Mira të Disponueshme (TMD), të forcohet sistemi i lejeve të integruara mjedisore (Tipi A), të futen instrumente të reja rregullatore si Sistemet e Menaxhimit Mjedisor (SMM), raporti bazë, monitorimi i mjedisit pritës dhe planet e transformimit industrial, si dhe të standardizohen procedurat e monitorimit, raportimit dhe sigurimit të përputhshmërisë.

Gjithashtu, ndërhyrja synon të përmirësojë menaxhimin e substancave të rrezikshme, të nxisë inovacionin, dekarbonizimin, efikasitetin e burimeve dhe ekonominë qarkulluese, të rregullojë në mënyrë më të plotë impiantet me djegie me kapacitet të mesëm, të zgjerojë fushën e zbatimit të legjislacionit për aktivitete të reja industriale me ndikim mjedisor dhe të rrisë transparencën dhe aksesin e publikut në informacionin mjedisor përmes sistemeve elektronike dhe Portalit të Shkarkimeve Industriale. Në të njëjtën kohë, synohet harmonizimi i plotë i kuadrit kombëtar me kërkesat e Direktivës 2010/75/BE, të ndryshuar, dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit evropian në kuadër të Kapitullit 27 "Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike".

3. Shkalla e ndërhyrjes

Shkalla e përshtatshme e ndërhyrjes konsiston në një ndërhyrje të targetuar në kuadrin rregullator ekzistues në nivel kombëtar, me synim përmirësimin dhe qartësimin e dispozitave aktuale. Ndërhyrja është e kufizuar në përmbajtje dhe nuk ka karakter rishikues të plotë të sistemit ligjor në fuqi, duke ruajtur strukturën dhe parimet bazë të tij. Ajo shoqërohet me përmirësime në aktet nënligjore zbatuese dhe me forcimin e kapaciteteve institucionale për zbatimin efektiv të kuadrit ekzistues, pa krijuar nevojën për struktura të reja administrative.

4. Mbështetja për objektivat e nivelit të lartë

Ndërhyrja është plotësisht në përputhje me objektivat e nivelit të lartë të qeverisë dhe zbaton Programin Politik të Këshillit të Ministrave dhe Programin Analitik të Akteve, të cilët parashikojnë rishikimin e kuadrit ligjor për leje mjedisi. Ajo mbështet përmbushjen e detyrimeve në kuadër të Kapitullit 27 "Mjedisi dhe ndryshimet klimatike" dhe procesit të integritetit evropian, nëpërmjet përafrimit me Direktivën 2010/75/BE për emetimet industriale (IED) dhe Direktivën (BE) 2015/2193 për impiantet e djegies me kapacitet të mesëm (MCPD). Gjithashtu, ajo kontribuon në zbatimin e politikave kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm, përdorimin efikas të burimeve dhe kalimin drejt një ekonomie me shkarkime të ulëta.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Në këtë kuadër, DSIP-ja për Direktivën 2010/75/BE (IED) përbën një dokument teknik të rëndësishëm për zbatimin praktik të detyrimeve të përafrimit me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e emetimeve industriale, duke përcaktuar hapat konkretë institucionalë, rregullatorë dhe teknike për zbatimin e kërkesave të Direktivës. Ndërkohë, Programi Politik i Këshillit të Ministrave përfaqëson kuadrin kryesor strategjik dhe politik që përcakton prioritetet e reformave qeveritare, përfshirë modernizimin e kuadrit rregullator mjedisor. Të dy dokumentet ofrojnë së bashku bazën e nevojshme politike dhe teknike për ndërhyrjen, duke kombinuar detyrimet e procesit të integritetit evropian me prioritetet e qeverisjes kombëtare.

5. Puna e kryer deri më tani

Nisma bazohet në një punë të konsiderueshme paraprake në fushën e lejeve të mjedisit. Në vijim të Konsultimit Kombëtar të vitit 2022, Ministria ndërmori një ndërhyrje të parë në ligjin nr. 10448/2011, e cila forcoi masat administrative dhe sanksionet për shkeljet e parashikuara në këtë ligj, përfshirë rritjen me 30% të masës së gjobave dhe përcaktimin e gjobës si titull ekzekutiv. Kjo ndërhyrje qartësoi gjithashtu rregullimin e regjistrimit të lejeve të mjedisit. Veprimtaria inspektuese ka qenë e vazhdueshme. Gjatë periudhës korrik 2020–gusht 2022, AKM-ja ka inspektuar 2 181 subjekte dhe ka vendosur 150 masa administrative, me një vlerë totale prej rreth 59,5 milionë lekësh. Këto masa kanë krijuar një bazë të rëndësishme për forcimin e zbatimit të legjislacionit mjedisor dhe kontrollit të përputhshmërisë së operatorëve.

Nisma mbështetet gjithashtu në përmirësimet e fundit institucionale dhe digjitale në sektorin e mjedisit, të cilat synojnë forcimin e kapaciteteve për monitorimin, raportimin dhe administrimin e integruar të të dhënave mjedisore. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 12.11.2025, u krijua baza shtetërore e të dhënave e Sistemit të Integruar të Mjedisit (SIM), e cila përbën një infrastrukturë të rëndësishme digjitale për grumbullimin, përpunimin dhe shkëmbimin e informacionit mjedisor ndërmjet institucioneve përgjegjëse. SIM do të mbështesë zhvillimin e bazës publike të të dhënave për lejet e mjedisit, publikimin elektronik të informacionit, raportimin e të dhënave të monitorimit dhe ndërlidhjen e tyre me veprimtarinë inspektuese. Në këtë mënyrë, ai kontribuon në rritjen e transparencës, përmirësimin e koordinimit ndërinstitutional dhe forcimin e vendimmarrjes së bazuar në të dhëna.

Nisma aktuale ndërton mbi këto zhvillime, duke e zhvendosur fokusin nga një qasje e orientuar kryesisht drejt masave ndëshkuese, drejt një sistemi më parandalues, të integruar dhe të harmonizuar me kërkesat e Direktivës 2010/75/BE për emetimet industriale (IED) dhe Direktivës (BE) 2015/2193 për impiantet e djegies me kapacitet të mesëm (MCPD).

OBJEKTIVI I POLITIKËS

Përcaktoni objektiva që i korrespondojnë problemit dhe shkaqeve të tij. Sigurohuni që objektivat e përcaktuara të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por në më shumë hollësi. Sigurohuni që objektivat të jenë specifike, të matshme, të arritshme, realistë dhe të përcaktuar në kohë.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Objekti i përgjithshëm i projektligjit është përmirësimi i cilësisë së mjedisit, përfshirë cilësinë e ajrit, dhe mbrojtjen e shëndetit publik, nëpërmjet përafrimit të mëtejshëm dhe zbatimit progresiv të kërkesave të Direktivës 2010/75/BE për shkarkimet industriale dhe Direktivës (BE) 2015/2193 për impiantet e mesme të djegies, si dhe nëpërmjet forcimit të mekanizmave të zbatimit dhe kontrollit në fushën e legjislacionit mjedisor.

Në mbështetje të këtij objekti të përgjithshëm, projektligji synon të arrijë objektivat specifike të mëposhtme:

- Integrimi i plotë i konceptit të Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD) në procesin e dhënies dhe zbatimit të lejeve të mjedisit, duke e shndërruar TMD-në nga një referencë në një kusht detyrues të lejes së mjedisit si dhe garantimi e përditësimit periodik të lejeve të mjedisit në përputhje me zhvillimet e TMD-së.
 - Sigurimi që, brenda vitit 2036, 100% e lejeve të mjedisit për instalimet e mbuluara nga Direktiva 2010/75/BE (IED) të jenë të rishikuara dhe të miratuara në përputhje me konkluzionet e zbatueshme të Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD) dhe niveleve të shkarkimeve të lidhura me to (TMD-AEL), të integruara si kushte detyruese në lejet përkatëse.
 - Përcaktimin e Vlerave Kufi të Shkarkimeve (VKSH) në përputhje me nivelet e shkarkimeve të lidhura me TMD-në (TMD-AEL) dhe rishikimin e kushteve të lejes brenda katër viteve nga publikimi i vendimit për konkluzionet mbi TMD-në që lidhen me veprimtarinë kryesore të instalimi
 - Forcimi i detyrimeve për monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve, duke përcaktuar detyrime të qarta për operatorët për kryerjen e vetëmonitorimit të vazhdueshëm dhe përditësimin në përputhje me TMD-të e rishikuara.
 - Krijimi i Sistemeve të Menaxhimit Mjedisor (SMM) të cilat sigurojnë përmirësimin e vazhdueshëm të performancës mjedisore nëpërmjet planifikimit, monitorimit dhe rishikimit sistematik të proceseve dhe ndikimeve mjedisore të veprimtarisë industriale
 - Sigurimi i vlerësimit dhe dokumentimit të gjendjes mjedisore para dhe pas veprimtarive me ndikim të lartë.
 - Forcimi i mekanizmave për parandalimin dhe rehabilitimin e dëmeve mjedisore gjatë dhe pas aktivitetit industrial.
 - Digjitalizimi i plotë i procedurave për dhënien e lejeve të mjedisit, brenda vitit 2035, duke përmirësuar efikasitetin administrativ, qasjen në të dhëna dhe mbikëqyrjen rregullatore.
 - Rritja e transparencës dhe pjesëmarrjes publike në proceset e vendimmarrjes mjedisore në përputhje me parimet e transparencës, përgjigjeve dhe Konventës së Aarhusit.
- Sigurimi i parandalimit dhe rehabilitimit efektiv të ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore në të gjitha veprimtaritë industriale me ndikim të lartë, duke garantuar përfshirjen e raportit të gjendjes fillestare dhe detyrime për rehabilitim, si dhe rishikimin e 100% të lejeve ekzistuese brenda vitit 2030.
- Përmirësimi i cilësisë dhe disponueshmërisë së të dhënave të monitorimit të shkarkimeve nëpërmjet sistemeve të raportimit digjital;

PËRSHKRIMI I OPSIONEVE TË SHQYRTUARA

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Përshkruani opsionin e status quo-së. Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni shqyrtuar. Shpjegoni se si u përzgjedhën opsionet e listuara.

Për arritjen e objektivave të politikës, u shqyrtuan katër opsione, të përzgjedhura sipas praktikës standarde të vlerësimit të ndikimit rregullator: status quo-ja si pikë referimi, një opsion jorregullator si provë e nevojës për ndërhyrje rregullatore dhe dy opsione rregullatore me intensitet të ndryshëm (ndryshimi kundrejt një ligji të ri).

Opsioni 0 (status quo) - Nuk ndërmerret asnjë ndërhyrje përmes ndonjë ndryshimi apo politike të re ndërkohë, kuadri ligjor ekzistues vazhdon të zbatohet njësoj dhe i pandryshuar. Sipas këtij opsioni, nuk merret asnjë masë për të shmangur problemet e identifikuar deri më tani. Ky opsion ka një avantazh të kufizuar, në drejtim të konsumit të burimeve njerëzore dhe financiare për kryerjen e studimeve të nevojshme për identifikimin e problemit dhe hartimin e nismës.

Avantazhet:

- Nuk ka kosto fillestare të reja;
- Stabiliteti i kuadrit ekzistues.

Disavantazhet:

- Nuk lejon përmbushjen e objektivave të Direktivës 2010/75/BE dhe Direktivës (BE) 2015/2193;
- Sistemi i lejeve të mjedisit do të mbetet i fragmentuar, pa garantuar një trajtim të unifikuar dhe të integruar të kërkesave mjedisore.
- Nuk siguron zbatimin detyrues të kërkesave të bazuara në Teknikat më të Mira të Disponueshme (TMD);
- Nuk adreson mangësitë në monitorim, raportim dhe kontroll.

Vlerësimi: Një opsion i papranueshëm, me rrezik të lartë për mjedisin dhe për procesin e integritetit.

Opsioni 1 (jorregullator) - Ky opsion do të mbështetej në përdorimin e mekanizmave jorregullatorë për të adresuar problemet e identifikuar.

Ky opsion do të mbështetej në përdorimin e mekanizmave jorregullatorë për të adresuar problemet e identifikuar, duke përfshirë udhëzime teknike, trajnime vullnetare dhe masa ndërgjegjësuere për reduktimin e ndotjes së mjedisit. Megjithatë, përvoja e deritanishme tregon se këto instrumente kanë efekt të kufizuar në mungesë të detyrimeve ligjërish të zbatueshme dhe mekanizmave të fortë monitorimi dhe kontrolli, duke rezultuar në zbatim të pabarabartë ndërmjet operatorëve dhe mungesë të standardizimit në nivel kombëtar.

Për më tepër, niveli i kompleksitetit të veprimtarive industriale dhe potenciali i lartë për ndikime negative në mjedis dhe shëndetin e njeriut kërkojnë ndërhyrje më të detyrueshme dhe të standardizuara, të cilat nuk mund të garantohen përmes vetërregullimit apo masave vullnetare. Në këtë kontekst, ky opsion u vlerësua i pamjaftueshëm për adresimin efektiv të problemeve të identifikuar.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Avantazhet:

- Kosto relativisht e ulët për buxhetin publik;
- Lehtësi zbatimi;
- Kontribuon në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut.

Disavantazhet:

- Nuk krijon detyrime ligjore për operatorët;
- Nuk siguron zbatimin e standardeve të BE-së;
- Nuk adreson në mënyrë efektive ndotjen industriale;
- Nuk përmirëson strukturën e sistemit të lejeve të mjedisit;
- Ka efekt të kufizuar dhe afatshkurtër.

Vlerësimi: Një opcion mbështetës, por jo i mjaftueshëm si ndërhyrja kryesore.

Opsioni 2 (ligj i ri)

Ky opcion konsiston në hartimin dhe miratimin e një ligji të ri gjithëpërfshirës në fushën e lejeve të mjedisit dhe menaxhimit të ndikimeve mjedisore, i cili do të zëvendësonte kuadrin ekzistues ligjor. Ai do të synonte riorganizimin e plotë të dispozitave aktuale, integrimin e kërkesave të Direktivës 2010/75/BE (IED) dhe Direktivës (BE) 2015/2193 (MCPD), si dhe riformatimin e procedurave të dhënies, monitorimit dhe zbatimit të lejeve të mjedisit në një akt të vetëm ligjor.

Ky është një opcion jo i preferuar, pasi rezultatet e tij në aspekt të përmbushjes së objektivave janë të ngjashme me ato të Opsionit 3, por kostot administrative, institucionale dhe të burimeve njerëzore janë më të larta. Gjithashtu, procesi i hartimit dhe miratimit të një ligji të ri kërkon një kohë më të gjatë, duke vonuar zbatimin e ndërhyrjeve të nevojshme dhe ekspozuar sistemin ndaj riskut të vazhdimit të problematikave ekzistuese.

Në këtë kontekst, duke qenë se ndërhyrja kërkon efekt të menjëhershëm për adresimin e mangësive të identifikuara në zbatimin e kuadrit aktual, ky opcion nuk konsiderohet i preferuar. Megjithatë, në rast të reformave më të thella strukturore ose rishikimit të gjerë të kuadrit ligjor ekzistues, hartimi i një ligji të ri mund të konsiderohet një alternativë e përshtatshme.

Avantazhet:

- Do të lejonte një ristrukturim të plotë të kuadrit ligjor;
- Mund të lejonte integrimin e plotë dhe të drejtpërdrejtë të acquis-së së BE-së;
- Mund të ofronte, në teori, qartësi më të madhe normative.

Disavantazhet:

- Nuk është proporcional me natyrën e ndërhyrjes, pasi ndryshimet e propozuara janë të synuara;
- Do të kërkonte një periudhë më të gjatë për hartim, konsultim dhe miratim;
- Mund të krijonte pasiguri juridike dhe sfida institucionale gjatë periudhës tranzitore;

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

- Mund të rrezikonte vonesa në përmbushjen e detyrimeve të lidhura me BE-në;
- Do të sillte kosto më të larta administrative dhe institucionale.

Vlerësimi: Një opsion që nuk është efikas dhe proporcional në këtë fazë.

Opsioni 3 (ndryshimi i ligjit ekzistues) -

Ky opsion konsiston në përmirësimin dhe ndryshimin e ligjit ekzistues nr. 10448/2011 “Për lejet e mjedisit”, përmes një pakete të synuar ndërhyrjesh ligjore që nuk ndryshojnë strukturën bazë të ligjit, por e përshtatin atë me kërkesat aktuale të *acquis* të Bashkimit Evropian, në veçanti Direktivën 2010/75/BE (IED) dhe Direktivën (BE) 2015/2193 (MCPD). Ndërhyrja synon forcimin e kushteve të lejeve të mjedisit, integrimin e detyrueshëm të Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD), përmirësimin e mekanizmave të monitorimit dhe raportimit, si dhe rritjen e efikasitetit të zbatimit dhe kontrollit administrativ.

Masat jorregullatore (ndërgjegjësimi, trajnimet vullnetare) mund ta plotësojnë ndërhyrjen, por nuk mund ta zëvendësojnë atë, pasi detyrimet kryesore kërkojnë një bazë ligjore. Për këtë arsye, ndërhyrja e qeverisë është e nevojshme dhe efektive.

Ky opsion përfaqëson qasjen e preferuar, pasi mundëson arritjen e objektivave të politikës publike në mënyrë më të shpejtë dhe me kosto më të ulët administrative dhe institucionale krahasuar me hartimin e një ligji të ri. Ai garanton vazhdimësinë e kuadrit ekzistues ligjor, duke shmangur ndërprerjet institucionale dhe duke lehtësuar zbatimin e menjëhershëm të ndryshimeve të nevojshme.

Avantazhet:

- Një instrument ligjor i mjaftueshëm dhe në kohë;
- Ndryshimet nuk prekin më shumë se 50% të dispozitave;
- Mundëson përafrimin me Direktivën 2010/75/BE (IED) dhe Direktivën (BE) 2015/2193 (MCPD) brenda një afati më të shkurtër kohor (ligji hyn në fuqi 18 muaj pas publikimit, kundrejt një afati shumë më të gjatë për një ligj të ri);
- Ruan vijimësinë e kuadrit dhe redukton rrezikun institucional.

Disavantazhet/kostot:

- Kosto shtesë për kapacitetet institucionale dhe monitorimin;
- Ngarkesë e shtuar për operatorët; nevojë për trajnim dhe përshtatje institucionale.

Vlerësimi: Një opsion proporcional, efikas dhe i realizueshëm.

Shtesë metodologjike – elementët e analizës kosto–përfitim (CBA)

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

VLERËSIMI I OPSIONEVE DHE ANALIZA E NDIKIMEVE

Identifikoni se kush preket. Identifikoni llojet e ndikimit për secilin grup të prekur; dalloni ndërmjet ndikimeve të drejtpërdrejta dhe të tërthorta. Për ndikimet e drejtpërdrejta: përshkruani në mënyrë cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura; analizoni në mënyrë sasiore ndikimet e drejtpërdrejta më të rëndësishme; monetizoni ndikimet e drejtpërdrejta më të rëndësishme kur është e mundur (shih Aneksin 1/a për një tabelë të përdorshme); analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Për ndikimet e tërthorta: përshkruani në mënyrë cilësore ndikimet e tërthorta mbi grupet e prekura; analizoni ndikimin mbi konkurrencën. Diskutoni kufizimet e analizës: jepni supozimet mbi të cilat bazohen parashikimet dhe rreziqet ndaj të cilave ato u nënshtrohen; tregoni sa e fortë, e pavarur dhe e rëndësishme është prova që mbështet supozimet; tregoni çfarë mund të pengojë që përfitimet të materializohen, të rrisë kostot, ose të sjellë të papritura pasoja. Përmbledhni vlerësimin e opsioneve: paraqitni një përmbledhje të përgjithshme të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara; shpjegoni se si krahasohen me njëri-tjetrin ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara; paraqitni vlerësimet neto më të mira të përgjithshme të ndikimit të monetizuar për secilin opsion (shih Aneksin 1/b për një tabelë të përdorshme).

Ky seksion vlerëson ndikimet e opsioneve të shqyrtuara, duke u përqendruar në opsionin e preferuar (Opsioni 3 – ndryshimi i ligjit), si dhe identifikon grupet e prekura dhe ndikimet ekonomike, mjedisore dhe sociale.

Grupet e prekura. Projektligji prek, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë:

- Operatorët ekonomikë;
- Qytetarët dhe komunitetet vendore;
- Institucionet publike në nivel qendror dhe vendor;
- Sistemin e shëndetit publik;
- Shoqërinë civile dhe publikun e interesuar.

Për të plotësuar analizën e ndikimeve, vlerësimi ekonomik i opsionit të preferuar mbështetet në një analizë kosto–përfitim orientuese, duke krahasuar kostot dhe përfitimet shtesë të Opsionit 3 kundrejt skenarit bazë/status quo. Analiza merr në konsideratë kostot për sektorin publik, kostot për operatorët ekonomikë dhe përfitimet mjedisore, shëndetësore, institucionale dhe ekonomike që priten nga zbatimi i projektligjit.

Në mungesë të të dhënave të plota për monetizimin e përfitimeve mjedisore dhe shëndetësore, analiza ekonomike plotësohet me vlerësimin cilësor të ndikimeve dhe me analizën shumëkriteriale (MCA), e cila rendit Opsionin 3 si alternativën më të favorshme.

Supozimet bazë të analizës janë: skenari bazë është vazhdimi i kuadrit aktual pa ndryshime ligjore; opsioni i analizuar është amendimi i ligjit ekzistues; horizonti kohor është 10 vite; faktorët e zbritjes janë ata të parashikuar në tabelën e RIA-s; kostot publike përfshijnë CAPEX rreth 7.5 milionë euro dhe OPEX rreth 2.9 milionë euro në vit; kostot private përfshijnë investimet e operatorëve kryesorë, nga të cilat 79.3 milionë euro janë investime të detyrueshme për përputhje me TMD dhe 35 milionë euro janë investime vullnetare të gjelbra.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Kostot publike lidhen me modernizimin e sistemit të lejimit, digjitalizimin e raportimit dhe monitorimit, forcimin e kapaciteteve institucionale, përgatitjen e metodologjive teknike, përmirësimin e infrastrukturës laboratorike dhe forcimin e kapaciteteve të Ministrisë përgjegjëse për mjedisin dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

Vlera aktuale orientuese e kostove publike, duke përdorur faktorët e zbritjes të tabelës së RIA-s, është rreth 31.08 milionë euro. Nëse shtohen investimet private të detyrueshme për përputhje me TMD, totali orientues i kostove të monetizuara është rreth 110.38 milionë euro. Investimet vullnetare të gjelbra duhet të paraqiten veçmas, pasi nuk përbëjnë detyrim të drejtpërdrejtë rregullator.

Përfitimet mjedisore pritet të jenë të konsiderueshme dhe afatgjata. Ato lidhen me uljen e ndotjes industriale, reduktimin e presionit mbi cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës, përmirësimin e menaxhimit të burimeve natyrore dhe krijimin e kushteve për një zhvillim industrial më të qëndrueshëm.

Përfitimet shëndetësore përfshijnë uljen e ekspozimit të popullsisë ndaj ndotësve industrialë dhe, rrjedhimisht, reduktimin e rrezikut për sëmundje të lidhura me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës. Përfitimet institucionale lidhen me standardizimin e procedurave, përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional dhe forcimin e transparencës përmes publikimit elektronik të informacionit mjedisor. *Ndikimet ekonomike:* - Përputhshmëria e plotë me kërkesat e reja për lejet e mjedisit do të kërkojë investime të konsiderueshme kapitale nga operatorët që përfshihen në fushën e zbatimit të IED-së. Bazuar në vlerësimin e detajuar të Teknikave më të Mira të Disponueshme (TMD), të kryer në periudhën mars–prill 2026, kërkesa totale për investime për shtatë operatorë prioritarë që përfaqësojnë tetë instalime industriale vlerësohet në rreth 114.3 milionë euro. Nga kjo shumë, 79.3 milionë euro përfaqësojnë investime të detyrueshme të nevojshme për arritjen e përputhshmërisë me TMD-në, ndërsa 35 milionë euro përbëhen nga investime vullnetare të gjelbra që synojnë dekarbonizimin dhe përmirësimin e eficiencës së energjisë. Sektori i çimentos përbën rreth 92% të programit total të investimeve, duke pasqyruar si shkallën e përmirësimeve mjedisore të kërkuara, ashtu edhe natyrën intensive në kapital të këtij sektori.

Vlerësimi i programit të investimeve është bazuar në një analizë të përputhshmërisë me Teknikat më të Mira të Disponueshme (TMD), të kryer nga ekspertët teknikë për shtatë operatorë prioritarë dhe tetë instalime, që përfshijnë pesë kategori veprimtarish IED. Për çdo instalim janë identifikuar boshllëqet ndaj konkluzioneve përkatëse për TMD-në, janë përcaktuar masat teknike të nevojshme për përmbushjen e tyre, kostot për njësi dhe afatet e zbatimit, në dialog me stafet teknike të operatorëve. Vlerësimet kanë karakter paraprak dhe shërbejnë për planifikimin në kuadër të DSIP-së, ndërsa për përcaktimin e buxheteve përfundimtare kërkohen studime fizibiliteti në nivel instalimi.

Programi i investimeve për operatorët arrin në 114,255 milionë euro. Prej kësaj shume, 79,255 milionë euro përfaqësojnë investime kapitale të detyrueshme për arritjen e përputhshmërisë me TMD-në, ndërsa 35 milionë euro janë investime vullnetare të gjelbra të planifikuara nga Antea Cement, e cila rezulton tashmë e përputhshme me kërkesat e TMD-së. Kostot e sektorit publik, përfshirë investimet kapitale prej 7,5 milionë eurosh, trajtohen veçmas nga investimet në nivel operatori dhe nuk përfshihen në shumën prej 114,255 milionë eurosh.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Vlerat për GSA Ferrokrom dhe CWI Albania janë përlogaritur në nivel mase teknike. Për GSA Ferrokrom, investimi prej 1,281 milionë eurosh përfshin zbatimin e sistemit të menaxhimit të energjisë, monitorimin e kromit, monitorimin e vazhdueshëm të pluhurit dhe përmirësimin e sistemeve të reduktimit të pluhurit. Për CWI Albania, investimi prej 0,002 milionë eurosh lidhet me monitorimin e shkarkimeve gjatë kushteve të funksionimit jo të zakonshëm dhe monitorimin e COD, TOC dhe HOI.

Për ALBCHROME, kostot ndahen ndërmjet dy instalimeve, me një total të kombinuar prej 6,430 milionë eurosh. Instalimi Fe-Cr Elbasan parashikon investime prej 1,950 milionë eurosh për masat e Sistemit të Menaxhimit Mjedisor, planin e çmontimit, dedustimin, sistemet e menaxhimit dhe trajtimit të ujërave, magazinimin e mbetjeve dhe skrapit, si dhe kanalizimet. Instalimi Fe-Cr Burrel parashikon investime prej 4,480 milionë eurosh për kontrollin e procesit, masat e SMM-së, dedustimin, pajisjet për reduktimin e pluhurit, magazinimin e mbetjeve dhe skrapit, si dhe sistemet e menaxhimit të ujërave.

Investimet vullnetare të Antea Cement arrijnë në 35 milionë euro dhe përfshijnë 5 milionë euro për përdorimin e copëzave të gomave si lëndë djegëse alternative, 5 milionë euro për sistemin e furnizimit me lëndë djegëse alternative, 20 milionë euro për rikuperimin e nxehtësisë së mbetur dhe 5 milionë euro për projektin fotovoltaiik. Këto masa janë pjesë e planit të rregullt të investimeve të operatorit dhe nuk përbëjnë kosto të detyrueshme për arritjen e përputhshmërisë me IED-në.

Investimi më i madh i detyrueshëm lidhet me Elbasan Cement Factory, me vlerë 70 milionë euro, për zëvendësimin e furrës me proces të lagësht me një furrë me proces të thatë, me parangrohje shumëfazore dhe parapjekës, përfshirë pajisjet e monitorimit dhe reduktimit të ndotjes. Kjo vlerë është përlogaritur nga eksperti teknik mbi bazën e kapacitetit aktual të furrës prej 500 ton/ditë, pasi operatori nuk kishte paraqitur plan të detajuar investimi ose sqarim për rifillimin apo çmontimin e instalimit.

Për Elbagas, investimi prej 0,040 milionë eurosh përfshin zbatimin e sistemit për reduktimin e shkarkimeve të gazeve dhe të Sistemit të Menaxhimit Mjedisor. Për Bitex Refinery, investimi prej 1,502 milionë eurosh përfshin monitorimin periodik të shkarkimeve difuze të VOC-ve, instalimin e pajisjeve për reduktimin e ndotjes së ajrit dhe përmirësimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura.

Burimet teknike të përdorura për përcaktimin e masave janë konkluzionet përkatëse për TMD-në dhe dokumentet referuese sektoriale, përfshirë BATC NFM për sektorin e metaleve me ngjyra, BATC FMP për përpunimin e metaleve të zeza, BREF CLM për çimenton, BREF SIC për instalimet kimike dhe BATC REF për rafinimin e naftës. Në rastet kur operatorët nuk kanë paraqitur plan të detajuar investimesh, kostot janë vlerësuar nga eksperti teknik.

Për analizën e aftësisë financiare të operatorëve janë përdorur të dhëna nga QKB-ja për vitin financiar 2024 dhe, kur kanë qenë të disponueshme, të dhëna nga pyetësorët e operatorëve. Për pesë operatorë, në mungesë të pyetësorëve të plotësuar, janë përdorur supozime neutrale për rritjen e të ardhurave, kostove operative dhe shërbimit të borxhit. Këto supozime lidhen me analizën e realizueshmërisë financiare dhe jo me përlogaritjen teknike të kostove të masave.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Ndikimet në sektorin privat: Konkurrueshmëria industriale: Standardet mjedisore të bazuara në Teknikat më të Mira të Disponueshme (TMD) krijojnë kushte të barabarta konkurrence për industrinë shqiptare dhe përmirësojnë konkurrueshmërinë në tregjet e BE-së dhe tregjet ndërkombëtare, ku përputhshmëria mjedisore është gjithnjë e më shumë kusht për akses në treg, veçanërisht për eksportet e çimentos dhe metaleve.

Krijimi i vendeve të punës dhe veprimtaria ekonomike: Programi i investimeve të operatorëve prej 114.3 milionë eurosh dhe CAPEX-i prej 7.5 milionë eurosh për sektorin publik do të gjenerojnë veprimtari të konsiderueshme ekonomike në ndërtim, inxhinieri, furnizimin me pajisje dhe shërbimet mjedisore, me efekte të vlerësuara të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në punësim prej 500–1,000 vite-punë gjatë periudhës së zbatimit.

Krijimi i vendeve të punës dhe veprimtaria ekonomike: Programi i investimeve të operatorëve, me vlerë 114,255 milionë euro, dhe investimet kapitale të parashikuara për sektorin publik, me vlerë 7,5 milionë euro, pritet të krijojnë kërkesë për punë, pajisje dhe shërbime në fusha të tilla si ndërtimi, inxhinieria, instalimi i pajisjeve, monitorimi dhe shërbimet mjedisore. Analiza sociale-ekonomike e DSIP-së vlerëson efektet e drejtpërdrejta, të tërthorta dhe të nxitura të veprimtarisë ekzistuese të operatorëve, duke përdorur multiplikatorë orientues për Vlerën e Shtuar Bruto, dhe jo koeficientë për krijimin e vendeve të punës nga investimet. Për këtë arsye, ndikimi në punësim paraqitet në mënyrë cilësore dhe do të mund të vlerësohet në mënyrë sasiore pas përgatitjes së studimeve të fizibilitetit dhe planeve të detajuara të zbatimit në nivel instalimi.

Reduktimi i detyrimeve mjedisore: Përputhshmëria proaktive me IED-në, përfshirë raportimin e gjendjes fillestare dhe planet për nxjerrjen jashtë funksionit, redukton kostot e ardhshme të rehabilitimit dhe detyrimet ligjore për operatorët dhe shtetin. Qasja në financimin e gjelbër: Operatorët në përputhje me IED-në do të kenë qasje të përmirësuar në instrumentet e financimit të gjelbër (linjat e kreditimit të gjelbër të EBRD/EIB, Fondi i Inovacionit i BE-së), duke ulur koston e kapitalit për investimet mjedisore . **Reduktimi i rrezikut të detyrimeve mjedisore dhe kostove të ardhshme:** Parashikimi i raportit të gjendjes fillestare, i masave për rehabilitimin e vendndodhjes dhe i detyrimeve që zbatohen pas ndërprerjes përfundimtare të veprimtarisë synon të përmirësojë parandalimin, identifikimin e hershëm dhe trajtimin e ndotjes së tokës dhe ujërave nëntokësore. Përfitimi ekonomik i kësaj mase nuk mund të kuantifikohet në këtë fazë, pasi varet nga kushtet konkrete të secilit instalim, niveli dhe shtrirja e ndotjes, masat teknike të nevojshme për rehabilitim dhe kostot që do të përcaktohen rast pas rasti.

Mundësia për financim të gjelbër: Investimet që lidhen me dekarbonizimin, efikasitetin energjetik, përdorimin e lëndëve djegëse alternative, rikuperimin e energjisë dhe ekonominë qarkulluese mund të krijojnë mundësi për akses në instrumente të financimit të gjelbër. Megjithatë, ulja e mundshme e kostonë së kapitalit nuk mund të vlerësohet paraprakisht, pasi ajo varet nga kushtet e instrumenteve financiare, struktura e projektit, aftësia financiare e operatorit dhe vlerësimi i pranueshmërisë për financim.

Efikasiteti i burimeve: Zbatimi i TMD-së nxit përdorimin më efikas të energjisë, ujit dhe lëndëve të para në nivel instalimi, duke reduktuar njëkohësisht kostot operative dhe ndikimin mjedisor. Në veçanti, ligji do të ketë implikime të drejtpërdrejta financiare për operatorët industrialë që i nënshtrohen kërkesave për leje të integruara mjedisi. Shkalla e ndikimit ndryshon ndjeshëm në varësi të sektorit, nivelit ekzistues të përputhshmërisë dhe kapacitetit financiar të operatorëve individualë.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Disa operatorë pritet të arrijnë përputhshmërinë nëpërmjet investimeve relativisht modeste të financuara nga burimet e tyre. Operatorë të tjerë do të kërkojnë masa tranzitore dhe qasje në mekanizmat e financimit me kushte lehtësuese për të përfunduar përmirësimet e nevojshme. Në veçanti, janë identifikuar investime prej përafërsisht 6.4 milionë eurosh për disa prej instalimeve metalurgjike, ku përputhshmëria konsiderohet teknikisht e arritshme, por kërkon një periudhë më të gjatë zbatimi përtej afatit standard të përputhshmërisë. Një sfidë më thelbësore është identifikuar për fabrikën e çimentos, ku përputhshmëria e plotë me TMD-në do të kërkonte një investim të vlerësuar prej 70 milionë eurosh, nivel shpenzimesh që tejkalon kapacitetin aktual financiar të operatorit dhe mund të kërkojë një kombinim të masave tranzitore, financimit të jashtëm, ristrukturimit strategjik ose zgjidhjeve alternative të investimit.

Referuar vlerësimit financiar të DSIP-së, ndikimi ekonomik dhe aftësia për financimin e masave të përputhshmërisë ndryshojnë sipas operatorëve, në varësi të nivelit të investimit të nevojshëm, situatës financiare të operatorit, flukseve të pritshme të parasë dhe mundësisë për të siguruar financim. Për këtë qëllim, DSIP-ja i klasifikon operatorët në katër kategori, duke dalluar rastet kur investimet mund të mbulohen nga burimet e vetë operatorit nga rastet kur kërkohet periudhë tranzitore ose mbështetje financiare e jashtme.

Një grup operatorësh, përkatësisht GSA Ferrokrom, CËI Albania, Bitex Refinery dhe Elbagas, mund të financojnë investimet e kërkuara për përputhshmëri me TMD-në nga flukset e tyre të brendshme të parasë. Kostoja e kombinuar e investimeve për këta operatorë është rreth 2,83 milionë euro dhe konsiderohet e përballueshme brenda afatit standard të përputhshmërisë deri në vitin 2030; për këtë kategori nuk kërkohet periudhë tranzitore.

Për ALBCHROME sh.p.k., e cila operon dy instalime të prodhimit të ferrokromit në Elbasan dhe Burrel, DSIP-ja ka identifikuar një kërkesë për investime prej 6,43 milionë eurosh. Këto investime konsiderohen teknikisht dhe financiarisht të realizueshme, por vetëm nëse ritmi i zbatimit riplanifikohet përtej afatit standard. Zbatimi i plotë i masave brenda periudhës 2026–2029 do të krijonte një mungesë të përkohshme të fluksit të parasë, ndërsa zbatimi i riplanifikuar siguron ruajtjen e një fluksi pozitiv financiar. Për këtë arsye, DSIP-ja e klasifikon këtë rast si të justifikuar për periudhë tranzitore prej gjashtë vjetësh, deri në vitin 2036, të kombinuar me financim nga burimet e operatorit dhe financim të gjelbër me kushte lehtësuese.

Sfida më e rëndësishme financiare lidhet me Elbasan Cement Factory sh.p.k., për të cilën përputhshmëria me kërkesat e TMD-së kërkon investim prej 70 milionë eurosh për zëvendësimin e plotë të furrës. DSIP-ja evidenton se gjendja aktuale financiare e operatorit, përfshirë mosfunksionimin e furrës, EBITDA-n negative dhe bazën në rënie të kapitalit, e bën të pamundur vetëfinancimin dhe jo të zbatueshëm financimin përmes kredive tregtare. Për këtë rast kërkohet kombinimi i financimit me kushte lehtësuese, injektimit të kapitalit, vendimmarrjes strategjike për rinisjen ose çaktivizimin e aktivitetit, apo zgjidhjeve të kombinuara. DSIP-ja parashikon gjithashtu një periudhë tranzitore prej gjashtë vjetësh, ndërkohë që nevojitet analizë financiare e mëtejshme në nivel instalimi.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Legjislacioni i propozuar pritet, për rrjedhojë, të rrisë kostot e përputhshmërisë në afat të shkurtër dhe të mesëm. Megjithatë, ai do të nxisë gjithashtu modernizimin teknologjik, përmirësimin e efikasitetit operacional, uljen e konsumit të burimeve, reduktimin e detyrimeve mjedisore dhe qasje më të madhe në instrumentet ndërkombëtare të financimit që mbështesin investimet industriale të gjelbra dhe me karbon të ulët. Qasja e zbatimit me faza dhe përdorimi i periudhave tranzitore synojnë të sigurojnë që detyrimet për përputhshmëri të mbeten proporcionale dhe ekonomikisht të realizueshme, duke ruajtur njëkohësisht progresin drejt objektivave mjedisore.

Ndikimet në Buxhetin e Shtetit: Zbatimi i ligjit do të kërkojë shpenzime publike shtesë për krijimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi efektiv të lejeve të mjedisit, monitorimit, inspektimit dhe zbatimit. Investimet për sektorin publik vlerësohen në përafërsisht 7.5 milionë euro shpenzime kapitale, që mbulojnë modernizimin e sistemeve të lejeve, digjitalizimin e raportimit dhe monitorimit të përputhshmërisë, zhvillimin e metodologjive dhe dokumenteve udhëzuese lidhur me TMD-në, forcimin e infrastrukturës laboratorike dhe rritjen e kapaciteteve institucionale pranë Ministrisë së Mjedisit dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit. Përveç kësaj, kostot vjetore operative vlerësohen në përafërsisht 2.9 milionë euro në vit, kryesisht të lidhura me stafin, inspektimet, funksionimin e laboratorëve, sistemet e teknologjisë së informacionit, trajnimet dhe veprimtaritë e vazhdueshme rregullore. Gjatë një periudhe zbatimi dhjetëvjeçare, kërkesa totale financiare për sektorin publik vlerësohet në përafërsisht 36.5 milionë euro, duke përfshirë si shpenzimet kapitale, ashtu edhe shpenzimet operative. Megjithëse këto shpenzime do të krijojnë kërkesa shtesë për buxhetin e shtetit, ato përfaqësojnë një investim të nevojshëm në qeverisjen mjedisore dhe përbëjnë vetëm rreth 7% të programit total të investimeve të kërkuara nga operatorët. Për më tepër, forcimi i administratës mjedisore dhe i sistemeve të përputhshmërisë pritet të lehtësojë përmbushjen e detyrimeve për anëtarësim në BE, të përmirësojë rezultatet mjedisore, të rrisë efektivitetin rregullator dhe të zgjerojë mundësitë për qasje në asistencën financiare të BE-së dhe ndërkombëtare për infrastrukturën mjedisore dhe zhvillimin institucional.

Ndikimet në Buxhetin e Shtetit: Sipas DSIP-së, kostot për sektorin publik ndahen në shpenzime kapitale njëherëshe (CAPEX) dhe shpenzime operative vjetore (OPEX), të nevojshme për funksionimin e sistemit të lejimit, monitorimit, inspektimit, raportimit dhe zbatimit të kërkesave të Direktivës 2010/75/BE.

Zëri i shpenzimit	Përmbajtja	Vlera e vlerësuar
CAPEX – Sisteme IT dhe regjistra	Baza e integruar e të dhënave për lejet IED dhe moduli i inspektimit	1,5 milionë euro
CAPEX – Pajisje inspektimi dhe monitorimi	Pajisje në terren, pajisje për marrjen e mostrave, automjete dhe mjete për administrimin e të dhënave	1,2 milionë euro
CAPEX – Laboratorë, sigurimi dhe kontrolli i cilësisë	Pajisje laboratorike, akreditim, metoda dhe trajnime fillestare	4,0 milionë euro
CAPEX – Udhëzime dhe metodologji	Udhëzime për TMD-në, modele të lejeve, lista kontrolli për inspektimet dhe procedura	0,8 milionë euro
Totali i shpenzimeve kapitale		7,5 milionë euro

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Shpenzimet kapitale për laboratorët përfshijnë krijimin e një ose dy laboratorëve rajonalë të AKM-së me kapacitete specifike për IED-në, përfshirë analizat e shkarkimeve nga oxhaku dhe verifikimin e sistemeve të monitorimit të vazhdueshëm të shkarkimeve, si dhe përmirësimin e laboratorëve ekzistues.

Zëri i shpenzimit vjetor	Përmbajtja	Vlera e vlerësuar
OPEX – Staf dhe funksionim	Lejimi, inspektimi, monitorimi dhe administrimi i të dhënave, për rreth 25–45 punonjës	0,85 milionë euro/vit
OPEX – Monitorim dhe shërbime laboratorike	Testime të shkarkimeve nga oxhaku, verifikimi i CEMS dhe analiza laboratorike	1,5 milionë euro/vit
OPEX – Mirëmbajtja e sistemeve IT	Hostim, licenca, mirëmbajtje dhe zhvillim progresiv	0,30 milionë euro/vit
OPEX – Trajnime dhe ngritje kapacitetesh	Trajnime të vazhdueshme, ndërkalibrim dhe përditësime metodologjike	0,25 milionë euro/vit
Totali i shpenzimeve operative vjetore		2,9 milionë euro/vit

Për një periudhë dhjetëvjeçare, kostoja totale e sektorit publik vlerësohet në rreth **36,5 milionë euro**, e përbërë nga 7,5 milionë euro shpenzime kapitale dhe 29 milionë euro shpenzime operative. Vlerësimet janë orientuese, të kalibruara sipas kontekstit institucional shqiptar, dhe do të rafinohen nëpërmjet planifikimit institucional nga Ministria dhe AKM-ja.

Transpozimi i plotë i IED-së është kërkesë sipas Kapitullit 27 (Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike) të acquis-së së BE-së. Përputhshmëria në kohë forcon pozicionin negociues të Shqipërisë dhe përshpejton qasjen në fondet e para-anëtarësimit të BE-së, fondet strukturore dhe instrumentet e politikës së kohezionit.

Ndikimi në krijimin e vendeve të punës dhe në veprimtarinë ekonomike drejtpërdrejt për sektorin privat do të ndikojë pozitivisht, në mënyrë të tërthortë, edhe në buxhetin e shtetit.

Në tërësi, ndonëse projektligji sjell kosto të konsiderueshme zbatimi, këto konsiderohen proporcionale me përfitimet e pritshme mjedisore, në shëndetin publik dhe ekonomike, si dhe zbuten nëpërmjet zbatimit me faza, masave tranzitore dhe mundësisë për mobilizimin e burimeve të jashtme të financimit.

Ndikimet institucionale: Në përgjithësi, projektligji kontribuon në modernizimin e administrimit mjedisor, duke rritur efikasitetin institucional, transparencën dhe cilësinë e vendimmarrjes në fushën e lejeve të mjedisit. Projektligji përcakton dhe qartëson rolet, përgjegjësitë dhe bashkërendimin ndërmjet institucioneve përgjegjëse për administrimin e regjimit të lejeve të mjedisit. Projektligji sjell ndikime të rëndësishme në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të institucioneve përgjegjëse për administrimin e regjimit të lejeve të mjedisit. Ai përcakton dhe qartëson më tej rolet dhe përgjegjësitë ndërmjet autoriteteve kompetente, duke reduktuar mbivendosjet funksionale dhe boshllëqet në

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

ushtrimin e detyrave institucionale. Kjo pritet të përmirësojë ndarjen e qartë të funksioneve ndërmjet procesit të dhënies së lejeve, monitorimit të zbatimit të kushteve të tyre dhe kontrollit inspektues.

Në të njëjtën kohë, projektligji forcon nevojën për bashkërendim ndërinstitutional më efektiv, duke vendosur mekanizma më të strukturuar për shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e veprimeve midis institucioneve përgjegjëse. Në këtë kuadër, përdorimi i sistemeve digjitale të integruara (si SIM) pritet të rrisë ndjeshëm eficiencën e komunikimit institucional dhe të sigurojë akses më të shpejtë dhe të standardizuar në të dhënat mjedisore.

Gjithashtu, zbatimi i kuadrit të ri kërkon forcimin e kapaciteteve administrative dhe teknike të institucioneve zbatuese, veçanërisht në lidhje me vlerësimin e përputhshmërisë me Teknikat më të Mira të Disponueshme (TMD), monitorimin e shkarkimeve dhe analizën e të dhënave të raportuara nga operatorët. Në periudhën fillestare të zbatimit mund të ketë rritje të ngarkesës administrative, e cila pritet të stabilizohet me konsolidimin e procedurave të reja dhe digjitalizimin e proceseve.

Ndikimet mjedisore: Ndikimi në mjedis pritet të jetë i konsiderueshëm dhe i drejtpërdrejtë: ulje e shkarkimeve në ajër, ujë dhe tokë nga instalimet industriale; Përqindja e reduktimit do të përcaktohet pas kryerjes së auditimeve dhe studimeve bazë. Reduktimi do të matet në nivel instalimi dhe ndotësi, mbi bazën e auditimeve fillestare, të dhënave të monitorimit dhe verifikimit të përputhshmërisë me TMD-AEL deri sa të arrihet niveli dhe % në përputhje me kërkesat e BE. Gjithashtu protot një kontroll më i mirë i ndotësve përmes kushteve të lejeve të mjedisit të bazuara në TMD dhe VKSH-ve më të rrepta; përmirësim i performancës mjedisore përmes SMM-së; mbrojtje më e mirë e ekosistemeve dhe biodiversitetit; reduktim i acidifikimit dhe eutrofikimit; si dhe kontribut në zbutjen e ndryshimeve klimatike përmes planeve të transformimit industrial me objektiva për vitin 2030, 2040 dhe neutralitetin klimatik deri në vitin 2050. Më konkretisht:

Reduktimi i shkarkimeve industriale në ajër: Vlerat kufitare të shkarkimeve të bazuara në TMD (TMD-AEL) do të reduktojnë shkarkimet e lëndës së grimcuar (PM/pluhur), dioksidit të squfurit (SO₂), oksideve të azotit (NO_x), përbërjeve organike të paqëndrueshme (VOC) dhe metaleve të rënda, përfshirë kromin, nga instalimet prioritare. Vetëm sektori i metaleve joferroze (Albchrome, GSA Ferrokrom) do të kërkojë sisteme të mëdha depuhurimi, të cilat do të reduktojnë shkarkimet e grimcave me një vlerësim prej 70–90%, duke përmirësuar drejtpërdrejt cilësinë e ajrit në rajonet e Elbasanit, Burrelit dhe Hasit. Përmirësimi i cilësisë së ujit: Instalimi i sistemeve të menaxhimit dhe trajtimit të ujit në venddepozitimet e skorieve dhe në vendndodhjet industriale do të parandalojë shkarkimin e pakontrolluar të ujërave të ndotura dhe lëngjeve kulluese në trupat ujorë. Këto masa janë veçanërisht thelbësore në zonat metalurgjike, ku ndotja e tokës dhe ujërave nëntokësore me metale të rënda përbën një shqetësim mjedisor të dokumentuar. Mbrojtja e tokës dhe ujërave nëntokësore: Raportet e gjendjes fillestare dhe planet e nxjerrjes jashtë funksionit, siç kërkohet sipas IED-së, do të identifikojnë dhe rehabilitojnë ndotjen e tokës në vendndodhjet industriale, duke parandaluar degradimin e mëtejshëm të burimeve tokësore dhe duke reduktuar detyrimet afatgjata për rehabilitim.

Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve: Ndërtimi i objekteve të posaçme të depozitimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme në instalimet metalurgjike do të eliminojë depozitimin e pakontrolluar të mbetjeve dhe do të reduktojë rreziqet e ndotjes së tokës dhe ujit.

Efikasiteti i energjisë dhe përfitimet bashkëshoqëruese për klimën: Zbatimi i sistemeve të menaxhimit të energjisë, në përputhje me ISO 50001, në instalimet IED, i kombinuar me investimet vullnetare të

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

gjelbra, të vlerësuara në 35 milionë euro, në lëndë djegëse alternative dhe rikuperimin e nxehtësisë së mbetur në sektorin e çimentos, do të kontribuojë në reduktimin e shkarkimeve të gazeve serrë dhe në angazhimet klimatike të Shqipërisë. Në mënyrë plotësuese ndaj kërkesave për përputhshmëri me TMD-në, Antea Cement ka parashikuar investime vullnetare të gjelbra me vlerë totale prej 35 milionë eurosh, të përfshira në planin e saj të rregullt të investimeve. Këto investime përfshijnë përdorimin e copëzave të gomave si lëndë djegëse alternative, instalimin e sistemit të furnizimit me lëndë djegëse alternative, rikuperimin e nxehtësisë së mbetur dhe prodhimin fotovoltaiik për vetëkonsum. Masat synojnë rritjen e zëvendësimit të lëndëve djegëse fosile, përmirësimin e efikasitetit energjetik dhe reduktimin e shkarkimeve indirekte të CO₂.

Ndikimet në shëndet dhe në aspektin sociale: Nisma e propozuar pritet të sjellë përfitime të konsiderueshme për shëndetin, nëpërmjet reduktimit të shkarkimeve industriale dhe përmirësimit të cilësisë së mjedisit. Nivelet më të ulëta të shkarkimeve të ndotësve në ajër, ujë dhe tokë pritet të kontribuojnë në uljen e sëmundjeve të frymëmarrjes dhe kardiovaskulare, uljen e normave të vdekshmërisë së parakohshme dhe përmirësimin e cilësisë së jetës. Këto përfitime do të jenë veçanërisht të rëndësishme për komunitetet e vendosura pranë zonave industriale dhe minerare, duke ndihmuar në reduktimin e pabarazive shëndetësore dhe promovimin e drejtësisë mjedisore. Për një përllogaritje më të saktë do të nevojitej një studim i posaçëm ekonomik për shëndetin, duke përdorur të dhëna ekspozimi specifike për Shqipërinë. Megjithatë, provat e pavarura të vlerësuara nga kolegët ofrojnë një bazë të qëndrueshme për vlerësim konservator. Studimi i JRC-së (Belis et al., Environment International, 2024, DOI: 10.1016/j.envint.2023.108347) vlerësoi kostot e jashtme për shëndetin nga ndotja e ajrit në 30 zona urbane të Ballkanit Perëndimor në vitin 2019. Konstatimet kryesore që lidhen me Shqipërinë përfshijnë:

- Rreth 4,000 vdekje të parakohshme në vit në Shqipëri i atribuohen ekspozimit ndaj PM2.5;
- Kostoja mesatare e vdekshmërisë së atribuueshme ndaj PM2.5 për çdo zonë urbane tejkalonte 200 milionë euro në vit;
- Një vlerësim konservator i kostove vjetore shëndetësore vetëm në katër zonat kryesore urbane të prekura në Shqipëri është në intervalin prej 800 milionë euro në vit (përafërsisht 76,256 milionë lekë).

Duke qenë se burimet industriale përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të shkarkimeve të PM2.5, SO₂ dhe metaleve të rënda në korridorin industrial Elbasan–Berat dhe zona të tjera të prekura, edhe një reduktim modest prej 5–10% i shkarkimeve industriale që rezulton nga përputhshmëria me IED-në do të përkthehej në kosto shëndetësore vjetore të shmangura në intervalin prej 40–80 milionë eurosh- duke tejkaluar ndjeshëm koston vjetore të të gjithë programit të përputhshmërisë me IED-në (përafërsisht 15 milionë euro/vit). Përfitimet shtesë për shëndetin përfshijnë uljen e rasteve të sëmundjeve të frymëmarrjes dhe kardiovaskulare në komunitetet pranë instalimeve IED, reduktimin e rreziqeve për shëndetin në punë nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit mjedisor në vendin e punës dhe reduktimin e ekspozimit ndaj metaleve të rënda, veçanërisht kromit heksavalent, në zonat përreth sektorit të ferrokromit. Ligji mund të ketë gjithashtu implikime të tërthorta sociale dhe ekonomike, pasi përputhshmëria me kërkesat e reja do të kërkojë investime të konsiderueshme nga disa operatorë industrialë.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit industrial për punësimin dhe ekonominë vendore, veçanërisht në rajonet industriale, zbatimi i shpejtë mund të krijojë presione financiare që mund të ndikojnë në veprimtarinë e biznesit dhe punësimin. Për të zbutur këto rreziqe, projektligji parashikon një qasje zbatimi me faza dhe periudha tranzitore, në varësi të marrëveshjes me Komisionin Evropian. Këto masa synojnë të balancojnë objektivat mjedisore me konsideratat socio-ekonomike, duke u lejuar operatorëve kohë të mjaftueshme për t'u përshtatur, duke mbrojtur njëkohësisht punësimin dhe duke mbështetur një tranzicion të drejtë drejt standardeve më të larta mjedisore.

Pjesëmarrja e zgjeruar e publikut dhe transparencë: IED-ja kërkon qasje të publikut në kushtet e lejeve të mjedisit, të dhënat e monitorimit të shkarkimeve dhe rezultatet e inspektimeve, duke forcuar qeverisjen mjedisore dhe angazhimin e qytetarëve në Shqipëri.

Përmirësimi i cilësisë së jetës: Reduktimi i shkarkimeve të pluhurit, zhurmës dhe aromave nga instalimet industriale do të përmirësojë drejtpërdrejt kushtet e jetesës për komunitetin pranë instalimeve IED, veçanërisht në bashkitë Elbasan, Burrel, Fier dhe Has.

E drejtësia mjedisore: Zbatimi i IED-së siguron që të gjithë operatorët industrialë të përmbushin të njëjtat standarde të larta mjedisore, duke reduktuar barrën disproporcionale të ndotjes mbi komunitetet pranë instalimeve të vjetra që nuk janë në përputhshmëri.

Forcimi i kapaciteteve institucionale: Programi i investimeve për sektorin publik (7.5 milionë euro CAPEX, 2.9 milionë euro/vit OPEX) do të krijojë kapacitete të qëndrueshme institucionale në lejet e mjedisit, inspektim dhe monitorim — duke përfutur qeverisjen mjedisore përtej përputhshmërisë me IED-në.

Përputhshmëria me kërkesat e reja do të kërkojë investime të konsiderueshme nga disa operatorë industrialë. Duke pasur parasysh rëndësinë e sektorit industrial për punësimin dhe ekonominë vendore, veçanërisht në rajonet industriale, zbatimi i shpejtë mund të krijojë presione financiare që mund të ndikojnë në veprimtarinë e biznesit dhe punësimin. Për të zbutur këto rreziqe, projektligji parashikon një qasje zbatimi me faza dhe periudha tranzitore, në varësi të marrëveshjes me Komisionin Evropian. Këto masa synojnë të balancojnë objektivat mjedisore me konsideratat socio-ekonomike, duke u lejuar operatorëve kohë të mjaftueshme për t'u përshtatur, duke mbrojtur njëkohësisht punësimin dhe duke mbështetur një tranzicion të drejtë drejt standardeve më të larta mjedisore.

Ndikimet në qeverisje dhe transparencë: Projektligji forcon pozicionin e Shqipërisë në integrimin evropian, redukton rrezikun e mospërputhshmërisë me acquis-në dhe përmirëson hartimin e politikave mjedisore. Nëpërmjet publikimit elektronik të informacionit (baza publike e të dhënave të lejeve të mjedisit, Portali i Shkarkimeve Industriale), ai rrit transparencën, forcon rolin monitorues të shoqërisë civile dhe besimin e qytetarëve tek institucionet.

Kufizimet e analizës: Vlerësimi mbështetet në analizën financiare të DSIP-së (të dhënat e audituara të vitit 2024 nga Regjistri i Biznesit dhe pyetësorët e operatorëve) dhe në praktikën e BE-së. Kostot e operatorëve që nuk janë vlerësuar ende do të përcaktohen nëpërmjet procesit të lejeve të mjedisit dhe vlerësimeve të mëtejshme të TMD-së. Vlerat CAPEX/OPEX për sektorin publik janë indikative; saktësia e tyre varet nga planifikimi institucional dhe shkalla e zbatimit. Përfitimet mjedisore dhe shëndetësore, ndonëse të mirëpërcaktuara, janë të vështira për t'u monetizuar plotësisht në kontekstin shqiptar.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Vlerësimi i përgjithshëm: Përfitimet mjedisore, shëndetësore dhe sociale janë të konsiderueshme, afatgjata dhe strukturore dhe pritet të tejkalojnë kostot për sektorin privat dhe institucionet. Krahasimi i opsioneve (analiza shumëkriteriale) e rendit Opsionin 3 në vendin e parë. Ndërhyrja përbën një investim strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm dhe për përmbushjen e detyrimeve të integritetit evropian.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë. Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Bazuar në analizën e kryer, opsioni i preferuar është Opsioni 3, ndryshimi i ligjit nr. 10448/2011 “Për lejet e mjedisit”.

Vlerësimi i përgjithshëm: Opsioni i preferuar nuk e rrit ndjeshëm barrën financiare, përmirëson në mënyrë të konsiderueshme efektivitetin e zbatimit, sjell përfitime të rëndësishme mjedisore dhe shëndetësore dhe mbështet procesin e integritetit evropian.

Justifikimi i zgjedhjes: Opsioni 3 është më i përshtatshmi për arritjen e objektivave, pasi adreson drejtpërdrejt problemet e identifikuara në zbatim, përmirëson efikasitetin e mekanizmave të kontrollit, monitorimit dhe raportimit dhe qartëson përgjegjësitë institucionale. Nëpërmjet ndryshimeve ligjore, forcohet zbatimi detyrues i kërkesave të bazuara në TMD, standardizohet monitorimi dhe raportimi i shkarkimeve nga instalimet, rritet niveli i përputhshmërisë së operatorëve dhe krijohet një bazë ligjore më e fortë për kontrollin e integruar të ndotjes.

Justifikimi nga këndvështrimi i teknikës së hartimit legjislativ

Nga këndvështrimi i teknikës së hartimit legjislativ:

- Ndërhyrjet e propozuara janë të synuara dhe nuk prekin më shumë se 50% të dispozitave të ligjit ekzistues;
- Ndryshimi i ligjit është një instrument proporcional dhe i mjaftueshëm për adresimin e problemeve;
- Shmang nevojën për hartimin e një ligji të ri, i cili do të kërkonte më shumë kohë dhe burime më të mëdha;

Për këtë arsye, ndryshimi i ligjit ekzistues konsiderohet zgjidhja më efikase dhe praktike.

Krahasimi me opsionet e tjera: Krahasuar me këto alternativa, Opsioni 3 siguron balancën më të mirë ndërmjet efektivitetit, kostos dhe afatit kohor të zbatimit.

Metodologjia e vlerësimit: Për vlerësimin e opsioneve është përdorur metoda e analizës shumëkriteriale (Multi-Criteria Analysis – MCA), duke marrë në konsideratë katër opsionet:

- Opsioni 0 – Ruajtja e status quo-së;
- Opsioni 1 – Opsioni jorregullator;
- Opsioni 2 – Hartimi i një ligji të ri për lejet e mjedisit;
- Opsioni 3 – Ndryshimi i ligjit “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Vlerësimi është bazuar në një grup kriteresh të përzgjedhura që pasqyrojnë objektivat e politikës dhe kërkesat e acquis-së së BE-së, si më poshtë:

- Krijimi i mekanizmave për minimizimin e ndotjes së mjedisit, përmirësimin e shëndetit dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve (5);
- Efektiviteti në mbrojtjen e interesit të qytetarëve për një mjedis të pastër (4);
- Aftësia për t'iu përgjigjur në kohë agjentëve ndotës dhe për sigurimin e mbrojtjes së mjedisit (3);
- Përbushja e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me fushën e lejeve të mjedisit (3);
- Efektiviteti i kostos (5).

Kritere	Peshë	Opsioni 0	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3
Krijimi i mekanizmave për të minimizuar ndotjen mjedisore, përmirësimin e shëndetit dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve	5	1 (5)	2 (10)	5 (25)	5 (25)
Efektiviteti në mbrojtjen e interesit të qytetarëve për një mjedis të pastër	4	1 (4)	2 (8)	4 (16)	4 (16)
Aftësia për t'iu përgjigjur në kohë agjentëve ndotës dhe për sigurimin e mbrojtjes së mjedisit	3	1 (3)	3 (9)	3 (9)	4 (12)
Përbushja e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare që lidhen me fushën e lejeve mjedisore	3	1 (3)	1 (3)	5 (15)	4 (12)
Kosto-efektivitet	5	2 (10)	3 (15)	2 (10)	5 (25)
Total		25	45	75	90

Pikët totale:

- Opsioni 0 → 25
- Opsioni 1 → 45
- Opsioni 2 → 75
- Opsioni 3 → 90 (më i larti)

Përfundime

Bazuar në analizën shumëkriteriale, Opsioni 3 rezulton si opsioni më i mirë i mundshëm, pasi:

- Siguron arritjen e objektivave të politikës;

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

- Është opsioni më efektiv nga pikëpamja e kostos;
- Mundëson përafrimin e mëtejshëm me Direktivën 2010/75/BE për shkarkimet industriale dhe me Direktivën (BE) 2015/2193 për impiantet e mesme të djegies;
- Mundëson zbatim më të shpejtë dhe më efektiv krahasuar me opsionet e tjera.

Për rrjedhojë, ky opsion përfaqëson ndërhyrjen më të përshtatshme për përmirësimin e cilësisë së mjedisit, përfshirë cilësinë e ajrit, forcimin e kontrollit të ndotjes industriale dhe mbrojtjen e shëndetit publik në Shqipëri.

ÇËSHTJET E ZBATIMIT

Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.

Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur. Përshkruani masat që do të merren gjatë zbatimit për arritjen e objektivave të politikës.

Strukturat përgjegjëse për zbatimin:

Zbatimi i projektligjit do të kryhet nëpërmjet një sistemi institucional të koordinuar, në përputhje me qasjen e kontrollit të integruar të ndotjes të parashikuar nga Direktiva 2010/75/BE për shkarkimet industriale, me përgjegjësitë e ndara si më poshtë:

- Ministria përgjegjëse për mjedisin, si institucioni udhëheqës për hartimin dhe koordinimin e politikave në fushën e lejeve të mjedisit, si dhe për sigurimin e përafrimit të mëtejshëm me acquis-në e BE-së;
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për vlerësimin teknik, monitorimin dhe verifikimin e përputhshmërisë me kushtet e lejes së mjedisit, VKSH-të dhe kërkesat e bazuara në TMD; rishikimin dhe përditësimin e lejeve të mjedisit; administrimin e raporteve të gjendjes fillestare dhe planeve të transformimit; si dhe publikimin e informacionit në bazën e të dhënave të lejeve të mjedisit;
- Strukturat përgjegjëse për inspektimin mjedisor, të cilat do të kontrollojnë përputhshmërinë me kushtet e lejeve të mjedisit dhe do të marrin masa administrative në rast shkeljesh, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB), për lëshimin e lejeve të mjedisit nëpërmjet sistemit elektronik;
- Operatorët ekonomikë, të cilët do të kenë përgjegjësinë e drejtpërdrejtë për përmbushjen e kushteve të lejes së mjedisit, monitorimin dhe raportimin e shkarkimeve, zbatimin e planit të transformimit dhe përmbushjen e detyrimeve për performancën mjedisore;

Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në rolin e tyre mbështetës për zbatimin e politikave mjedisore në nivel vendor, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi. **Pengesat e mundshme për zbatimin**

- Kapacitete të kufizuara teknike dhe njerëzore për lejet e mjedisit, monitorimin, raportimin dhe verifikimin e përputhshmërisë;

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

- Koordinim i pamjaftueshëm ndërmjet Ministrisë së Mjedisit, AKM-së, QKB-së, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve sektoriale;
- Mungesa e integritetit të plotë të sistemeve të raportimit dhe menaxhimit të të dhënave;
- Kompleksiteti teknik i lejeve të mjedisit të bazuara në TMD dhe i vlerësimit të TMD-AEL-ve;
- Kapacitete të kufizuara financiare të disa operatorëve të vegjël për arritjen e përputhshmërisë brenda afateve;
- Pasiguria ekonomike që mund të vonojë investimet private.

Masat për zbatim efektiv

- Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe teknike, me trajnime për strukturat zbatuese;
- Përgatitja e legjislacionit dytësor, metodologjive dhe udhëzimeve për lejet e mjedisit, monitorimin dhe raportimin, brenda afateve të ligjit (aktet kryesore nënligjore brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi);
- Zhvillimi i sistemeve të integruara të monitorimit dhe raportimit nëpërmjet SIM-it, deri në funksionalizimin e plotë të sistemit elektronik të lejeve të mjedisit (jo më vonë se 31 dhjetor 2035);
- Rishikimi dhe përditësimi i lejeve të mjedisit në përputhje me konkluzionet e TMD-së (brenda 4 viteve nga publikimi i tyre) dhe sigurimi i përputhshmërisë së impianteve të mesme të djegies (deri më 1 janar 2030);
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe shkëmbimit të të dhënave;
- Zbatimi me faza, kur justifikohet, veçanërisht për operatorët që kërkojnë përshtatje teknike ose investime.

Rreziqet ekonomike dhe masat zbutëse

Përveç pengesave institucionale dhe teknike, zbatimi i opsionit të preferuar mund të ndikohet nga rreziqe ekonomike dhe financiare. Rreziqet kryesore lidhen me kapacitetin financiar të disa operatorëve për të përballuar investimet e nevojshme të përputhshmërisë, mundësinë e rritjes së kostove të pajisjeve dhe teknologjive mjedisore, si dhe vonesat në mobilizimin e fondeve publike për modernizimin e sistemit të monitorimit dhe raportimit.

Masat zbutëse përfshijnë zbatimin gradual të detyrimeve, përdorimin e periudhave tranzitore kur është e justifikuar, mobilizimin e fondeve të BE-së dhe burimeve të tjera të financimit të gjelbër, përgatitjen e udhëzimeve teknike për operatorët, forcimin e kapaciteteve të AKM-së dhe strukturave inspektuese, si dhe monitorimin periodik të kostove reale gjatë zbatimit.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit:

*Paraqisni një përshkrim përmbledhës të masave të monitorimit dhe vlerësimit.
Identifikoni kriteret/treguesit për matjen e arritjes së objektivave ose progresit drejt tyre.*

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

Monitorimi ekonomik i zbatimit: Përveç treguesve mjedisorë dhe institucionalë, monitorimi i zbatimit duhet të përfshijë edhe tregues ekonomikë dhe financiarë për të verifikuar nëse kostot dhe përfitimet po materializohen sipas pritshmërive të RIA-s.

Treguesit ekonomikë të rekomanduar përfshijnë: shpenzimet publike faktike për CAPEX dhe OPEX; investimet e realizuara nga operatorët për përputhje me TMD; numrin e operatorëve që përdorin financim preferencial ose periudha tranzitore; kostot administrative të raportimit dhe vetëmonitorimit; si dhe të dhënat e matshme për uljen e shkarkimeve, të cilat mund të përdoren për monetizimin e përfitimeve në përditësimin e ardhshëm të CBA-së.

Masat e monitorimit dhe vlerësimit: Monitorimi mbështetet në kuadrin ligjor ekzistues: ligji nr. 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” parashikon Rrjetin Kombëtar për Monitorimin e Gjendjes së Mjedisit, i cili shtrihet në të gjithë territorin dhe ka AKM-në si autoritetin kompetent administrues, ndërsa ministria përgjegjëse për mjedisin harton politikat e mbrojtjes dhe monitorimit.

Masat kryesore të monitorimit janë:

- Monitorimi i zbatimit të politikave mjedisore nga Ministria dhe AKM-ja;
- Vetëmonitorimi nga operatori i burimeve të shkarkimeve dhe i mjedisit pritës, në përputhje me kushtet e lejes së mjedisit;
- Raportimi periodik i vetëmonitorimit nga operatorët pranë AKM-së, nëpërmjet SIM-it dhe Portalit të Shkarkimeve Industriale;
- Inspektime të rregullta dhe të paparalajmëruara nga strukturat e inspektimit mjedisor, me verifikimin në terren të të dhënave të raportuara;
- Rishikimi dhe përditësimi i kushteve të lejes së mjedisit brenda 4 viteve nga publikimi i përfundimeve përkatëse të TMD-së.
- Qëndrueshmëria e sistemit mbështetet gjithashtu nga kalimi i tarifave të rishikimit dhe tarifave vjetore të lejeve të mjedisit në llogarinë e AKM-së, çka forcon kapacitetin e saj monitorues.

Përveç monitorimit të vazhdueshëm, parashikohet një vlerësim periodik i efektivitetit të ligjit pra, nëse objektivat janë arritur ose janë në rrugën e duhur, nëse janë shfaqur pengesa dhe nëse nevojiten përshtatje ligjore ose të legjislationit dytësor. Matja kryhet kundrejt një baze referuese ekzistuese: gjatë periudhës 2020–2022, AKM-ja kreu rreth 2,181 inspektime dhe vendosi 150 masa administrative në fushën e mjedisit. Vlerësimi përfshin gjithashtu progresin në përafrimin me acquis-në, në kontekstin e raportimit për Kapitullin 27 dhe DSIP-në për Direktivën 2010/75/BE.

Treguesit për matjen e arritjes së objektivave

- Përqindja e operatorëve në përputhje me kushtet e lejes së mjedisit;
- Numri dhe përqindja e tejkalimeve të VKSH-ve kundrejt numrit total të matjeve gjatë periudhës së raportimit;
- Numri i lejeve të mjedisit të rishikuara dhe të përditësuara në përputhje me konkluzionet e TMD-së (brenda afatit 4-vjeçar);
- Numri i instalimeve të tipit A me leje të integruar të bazuar në TMD dhe TMD-AEL;
- Përqindja e operatorëve që paraqesin raporte të plota dhe në kohë;

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

- Numri i impianteve të mesme të djegies në përputhje me VKSH-të brenda afatit (1 janar 2030);
- Niveli i zbatimit të SMM-së dhe i planeve të transformimit nga operatorët;
- Numri i inspektimeve dhe masave administrative, krahasuar me bazën referuese 2020–2022, si tregues i forcimit të zbatimit;
- Statusi i funksionimit të sistemit elektronik të lejeve të mjedisit (deri më 31 dhjetor 2035);
- Niveli i publikimit online të informacionit mjedisor (baza e të dhënave të lejeve të mjedisit dhe Portali i Shkarkimeve Industriale);
- Numri i akteve nënligjore të miratuara (brenda 12 muajve) dhe vlerësimi i Komisionit Evropian në raportet vjetore për Kapitullin 27.

	Y1	Y2	Y3	Y4	Y5	Y6	Y7	Y8	Y9	Y10
Faktori i zbritjes	1.000000	0.952835	0.907894	0.865073	0.824271	0.785394	0.748351	0.713055	0.679423	0.647378
Kosto për buxhetin – vetëm një herë	353,475	212,085	141,390							
Kosto për buxhetin – të vazhdueshme	273,354	273,354	273,354	273,354	273,354	273,354	273,354	273,354	273,354	273,354
Kosto për bizneset – vetëm një herë	1,107,555	2,645,564	200,460	142,490	65,982	9,426	0	0		
Kosto për bizneset – të vazhdueshme	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.
Kosto për grupet e tjera – vetëm një herë	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.
Kosto për grupet e tjera – të vazhdueshme	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.
Kosto totale	1,734,384	3,131,003	615,204	415,844	339,336	282,780	273,354	273,354	273,354	273,354
Kosto e zbritur = Kosto totale × faktori i skontimit	1,734,384	2,983,329	558,540	359,735	279,705	222,094	204,565	194,916	185,723	176,963
Përfitime për buxhetin – vetëm një herë ¹	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.
Përfitime për buxhetin – të vazhdueshme	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

	Y1	Y2	Y3	Y4	Y5	Y6	Y7	Y8	Y9	Y10
Përfitime për grupet e tjera – vetëm një herë	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.
Përfitime për grupet e tjera – të vazhdueshme	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.
Përfitime për bizneset – vetëm një herë	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.
Përfitime për bizneset – të vazhdueshme	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.
Përfitime për të gjitha grupet – të vazhdueshme	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	N.a.	754,080	1,508,160	2,262,240	3,016,320	3,770,400
Përfitime totale	0	0	0	0	0	754,080	1,508,160	2,262,240	3,016,320	3,770,400
Përfitimi i skontuar = Përfitimi total × faktori i skontimit	0	0	0	0	0	592,250	1,128,633	1,613,102	2,049,357	2,440,874
Vlera aktuale totale e përfitimeve	7,824,216									
Vlera aktuale totale e kostove	6,899,954									
Vlera aktuale neto (VAN) = Vlera aktuale totale e përfitimeve – Vlera aktuale totale e kostove	924,262									

1. Shpërndarje e përafërt e kostove gjatë tre viteve, me peshë më të madhe në vitet e para për ngritjen e sistemit elektronik (SIM), pajisjet dhe laboratorët.
2. CAPEX-i i Elbasan Cement Factory sh.p.k. nuk është përfshirë për shkak të mungesës së vendimit të administrimit për rifillimin e instalimit; në rastet kur nuk është propozuar një plan investimi nga operatori privat, është propozuar një plan i përafërt nga ekipi ESP për qëllimet e kësaj shtojce.
3. Përfitimet e vlerësuara për shëndetin nga reduktimi i shkarkimeve industriale, bazuar në supozimet konservatore: (i) ndikimi pozitiv fillon në vitin e gjashtë, pasi investimet kryesore për përputhshmëri janë zbatuar nga operatorët privatë në pesë vitet e para, (ii) një normë në rritje e reduktimit të shkarkimeve industriale prej 1 për qind në vit, (iii) deri në kufirin prej 5 për qind në vitin e fundit, (iv) bazuar në vlerësimin vjetor të kostove shëndetësore për Shqipërinë në Belis et

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

al., *Environment International*, 2024, DOI: 10.1016/j.envint.2023.108347; për shkak se vlerësimi i disponueshëm i kostove shëndetësore është total dhe nuk specifikohet sipas grupeve të kërkuara në këtë shtojcë, është shtuar një kategori përfitimi shtesë, ku sektori publik dhe sektori privat paraqiten së bashku.

Shënim 1: Për paraqitjen në lekë të vlerësimeve të kostove dhe përfitimeve është përdorur kursi i këmbimit 94.26 lekë/euro, sipas Bankës së Shqipërisë, me përditësimin e fundit më 24.06.2026.

Shënim 2: DSIP-ja për IED/MCPD (prill 2026) përcakton koston totale indikative të investimeve publike (CAPEX) prej rreth 7.5 milionë eurosh dhe koston operative (OPEX) prej rreth 2.90 milionë eurosh në vit, me një total të agreguar 10-vjeçar prej rreth 36.5 milionë eurosh. Shpërndarja vjetore për tre vitet e para ende nuk është përcaktuar dhe do të specifikohet nga planifikimi institucional i Ministrisë së Mjedisit dhe AKM-së, në kuadër të planifikimit buxhetor afatmesëm. Kostot pritet të jenë graduale, me peshë më të madhe në vitet e para për ngritjen e sistemit elektronik (SIM), pajisjet dhe laboratorët.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

Jepni një përshkrim përmbledhës të masave të monitorimit dhe vlerësimit. Identifikoni kriteret/treguesit për matjen e arritjes së objektivave ose përparimit drejt tyre.

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit – Aneksi 2/b

Tabela për krahasimin ekonomik të opsioneve

- Opsioni 0 – Status quo: 0 kosto shtesë direkte, 0 përfitime shtesë, vlera aktuale neto 0.
- Opsioni 1 – Masa jorregullatore: kosto e ulët, jo e vlerësuar në mënyrë monetare; përfitim i kufizuar, kryesisht ndërgjegjësim; VAN nuk llogaritet për shkak të efektit të kufizuar.
- Opsioni 2 – Ligj i ri: kosto më e lartë se Opsioni 3 për shkak të procesit më të gjatë dhe burimeve shtesë institucionale; përfitime të ngjashme me Opsionin 3, por me vonesë në realizim; VAN nuk llogaritet për shkak të mungesës së të dhënave të plota.
- Opsioni 3 – Amendim i ligjit ekzistues: përdoret MCA dhe prag orientues përfitimi.

Opsion	Vlera aktuale (milion EUR)		Vlera aktuale neto (milion EUR)
	Kosto	Përfitim	
Opsion 3	73	83	10

Shënim: Një vlerë aktuale neto paraprake është llogaritur vetëm për opsionin e preferuar 3. Vlera aktuale neto për secilin nga opsionet e tjera nuk është llogaritur, pasi ajo varet nga monetizimi i përfitimeve, i cili do të kryhet në një fazë të mëvonshme të analizës. Krahasimi i opsioneve në këtë [1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.

fazë është kryer nëpërmjet analizës shumëkriteriale (MCA), e cila e rendit Opsionin 3 në vendin e parë me 90 pikë.

MINISTËR
Sofjan Jaupaj

[1] Burimi: Plani i Zbatimit Specifik për Direktivën (DSIP) për Direktivën 2010/75/EU (IED), Prill 2026.